



SHIKOJ.COM

KRIMI I

ËN SHQIPTARIAN E TRAKET

Përmes viseve serbe

Përktheu nga origjinali: XHEVAT LLOSHI

KREU I

PËR SHQIPTARIN E VERIUT

«Çështja e Lindjes» siç e quajnë, është e vështirë, sepse ajo nuk është aspak «një» çështje, por një lëmsh me çështje dhe, duke dashur që t'i gjesh zgjidhje njërës, i bën edhe më të vështira të tjerat për t'i zgjidhur. Ndërmjet tyre, çështja shqiptare është më e vështira për ta zgjidhur dhe asaj ende nuk i është kushtuar vëmendja që kërkon dhe që së shpejti do të jetë e detyrueshme t'i kushtohet. Ka pak njerëz në Perëndim, ose mund të thosha nuk ka asnjë njeri që nuk ka qenë në Shqipëri dhe që do të mund ta kuptonte se sot në Evropë jeton një popull i tërë, një bashkësi e lashtë qeniesh njerëzore parake në një vend, ku jo vetëm nuk ka fare rruge për mjete udhëtimi, por madje edhe ato shtigje të vetme që ekzistojnë, janë shumë të këqija për të kaluar me kalë, ndërsa kushtet e jetës janë ato të kohëve të gjendjes primitive parahistorike* dhe shumica e popullsisë vështirë se ka arritur shkallën mesjetare të qytetërimit.

Askush nuk e di se kur kanë ardhur shqiptarët në Evropë dhe autoritetet shkencore kanë mendime të ndryshme se cilat janë lidhjet e afërisë së tyre me popujt e tjerë, por nuk ka asnjë dyshim se ata janë pasardhës të drejtpërdrejtë të fiseve primitive, që kanë banuar në Gadishullin e Ballkanit, përpara grekëve e përpara romakëve dhe që i kanë quajtur me emra të ndryshëm ilirë, trakë e maqedonas, sipas trevave, ku kanë banuar. Paraardhësit e shqiptarëve i kanë përshkruar si luftëtarë të çartur e shumë të egër dhe nga radhët e tyre kanë dalë disa nga ushtarakët më të mirë të Romës. Atyre nuk u kanë munguar edhe njerëzit e mençur, këta burra, me gjakun barbar

* Autorja ka parasysh gjendjen e prapambetur të krahinave të thella malore gjatë sundimit osman.

të Ballkanit, u ngritën në shkallën e atyre që qeverisën vetë pushtuesin dhe i dhanë Perandorisë Romake një listë perandorësh, duke përfshirë midis tyre Dioklecianin* dhe Kostandinin e Madh.**

Shumë perandori janë ngritur e shumë kanë rënë, kurse shqiptari ka mbetur po ai, i pashtuar. Roma e fuqishme u rrokullis, atë e pasuan serbi, Venediku dhe osmani. «I përfshirë brenda pushtimeve», por kurrë i nënshtruar, shqiptari tërhoqej në kështjellat natyrore të maleve dhe ndiqte atë që i thoshte zemra e vet, pa pyetur të ashtuquajturin sundimtar. Shqiptari i sotëm është sa për emër nën sundimin turk, po vetëm sa për emër.

Qëndrimi i shqiptarëve kundrejt Turqisë është mjaft i veçantë. Siç thonë vetë turqit, ai ka cilësi të mrekullueshme, por edhe ata që e duan më shumë nuk pretendojnë se ai është përpjekur ndonjëherë t'i qytetërojë, t'i zhvillojë popujt që ka nën sundim ose qoftë edhe t'u përmirësojë në ndonjë farë mënyre kushtet. Nën osmanin ndërpritet çdo zhvillim dhe asgjë nuk jep fryt. Në pjesën më të madhe shqiptari ka mbetur në atë pikë, ku kishte arritur kur erdhi osmani dhe, me përjashtim të pisqollës e të pushkës me vetëmbushje që ka përvetësuar, nuk ka bërë asnjë hap përpara. Ai është një copë që ka mbijetuar nga ajo e kaluar, e cila ka vdekur dhe është harruar në Evropën Perëndimore.

Gjuha e tij u ka nxjerrë shumë probleme filologëve. Është një gjuhë e butë, me tingëllim të këndshëm, plot me «shshsh» të dyfishta dhe me disa tinguj bashkëtingëllorë të çuditshëm, aq të pazakonshëm sa që nuk mund t'u përshtatet asnjë nga alfabetet e njohura dhe prandaj nuk është gjetur mënyra sesi të jepet me shkrim.*** Kohët e fundit, janë bërë disa përpjekje, më shumë nga të huajt, për ta zbutur këtë gjuhë të pashtuar, duke i vënë një alfabet dhe janë përpunuar tre a katër sisteme, të gjitha pak a shumë të pakënaqshme, sepse nuk ka një alfabet që të përballojë tingujt e saj të veçantë pa ndihmën e shenjave

* Aurelius Valerius Diocletianus, perandor i Romës në vitet 284-305 me prejardhje ilire.

** Flau Valer Constantinus (270-337), perandor i Romës, në vitet 306-337, me prejardhje ilire, themeluesi i Konstandinopolit (Stambollit të sotëm).

*** Një nga alfabetet e vjetra të shqipes është përpunuar që në shek. XVI dhe, vetëm katër vjet pas botimit të këtij libri, u ngulit përfundimisht alfabeti i sotëm.

të tjera plotësuese. Në Shqipërinë e Veriut, është i parapëlqyer një alfabet me shkronja latine dhe i mbushur me shenja jetë gjuhë e shkollave, ndërsa shumica e popullsisë nuk di gjuhë tjetër, kështu që Shqipëria po mbetet një vend pa letërsi, pa histori,* madje edhe pa një gazetë të përditshme. Nuk është ndonjë bëmë të kesh e të përdorësh një gjuhë të pashkruar në Evropën e shekullit të njëzetë. Kjo na çon prapa në kohët e largëta prehistorike, na ballafaqon me ditët e historisë së pashkruar dhe na shtyn të mendojmë se shqiptarika ide parake, të papërpunuara e, ndoshta, që është më mirë të mos shkruhen. Kërkimet tona për lashtësinë e gjallë nuk mund të na çojnë më tej. Por, në kundërshtim me lashtësinë e tyre, shqiptarët janë një popull me moshë të re, sa është e pabesueshme dhe nuk kanë asnjë dijeni për botën e jashtme. Ata janë ende në etapën më të hershme të historisë në jetën e një kombi dhe ende nuk e kanë kapërcyer formën fisnore të jetesës.**

Shqiptarët u pagëzuan të krishterë në një periudhë të hershme, disa thonë rreth shekullit të katërt, por kjo na duket e dyshimtë.*** Nuk kam qenë në gjendje ta zbuloj cili njeri ose cilët njerëz kanë pasur aq ndikim të fuqishëm sa të kthenin këtë popull shumë konservues. Ka edhe një fakt të shënuar që, ndërsa gjithë të krishterët e Ballkanit, që herët u hodhën me kishën e Lindjes dhe të gjitha përpjekjet e papëve për t'i mbajtur kanë dështuar, shqiptarët e Veriut i kanë mbetur besnikë kishës katolike.

Malet e Shqipërisë, ashtu si ato të Malit të Zi, janë vargje të kështjellave natyrore, ndërmjet të cilave një ushtri e vogël sulmuese mund të grihet fare, ndërsa një ushtri e madhe dergjat e uritur. Për më tepër, një pjesë e madhe e vendit nuk e vlen të luftosh për ta pushtuar. Fiset janë jashtëzakonisht të egra dhe do të duheshin shumë përpjekje për t'i mposhtur.

* Letërsia shqiptare në fillim të shek. XX tashmë kishte krijuar një traditë të pasur, si edhe ishin botuar vepra historike nga autorët shqiptarë.

** Pohime të tilla në këtë libër lidhen me faktin se autorja interesohej për një pjesë të vogël të popullsisë shqiptare, ndërsa shkalla e përgjithshme e zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit ishte krejt e ndryshme nga sa paraqitet në këto radhë.

*** Krishterimi është përhapur si fe ilegale në Iliri që në shek. I. Në librin e saj të fundit autorja e saktëson vetë këtë.

Fakti që ata i përkasin kishës perëndimore* dhe jo lindores, i pengon që të bashkohen me popujt e tjerë të krishterë. Një herë dhe vetëm një herë ata arritën të fitonin një ekzistencë kombëtare të njohur dhe kjo ka ndodhur nën udhëheqjen e Skënderbeut të madh. Por, Skënderbeu vdiq më 1468 dhe që atëherë nuk ka dalë dikush, i cili të jetë i aftë, që t'i mbrujë këto fise gjysmë të pavarura në një tërësi të pandashme. Turqit arrijnë të sigurojnë paqen me to duke i lënë të bëjnë si të duan në malet e tyre. Shqiptarët u shkëpusin privilegje turqve, duke luftuar për ta dhe duke i dhënë ushtrisë osmane, ashtu siç kishin bërë dikur për romakët, disa nga ushtarët më të mirë. Shqipëria e sotme mbetet e ndarë në disa fise të veçanta, që qeverisen nga krerët e tyre sipas ligjeve të pashkruara, të cilat janë trashëguar gojarisht nga një e kaluar shumë e largët. «Qeveria» turke praktikisht nuk hyn fare në këtë mes. Ose, sidoqoftë, edhe kur thotë ndonjë gjë, nuk ka fuqi që ta zbatojë.

Shqiptarët është i paditur e i pamësuar, por nuk është budalla. Ideja e vetme udhëheqëse për të ka qenë të vazhdojë të jetojë ashtu siç kanë jetuar stërgjyshët e tij. Ai i ka kapur shpejt të gjitha nyjat që do t'ia jepnin këtë mundësi dhe u është mbajtur fort atyre. Malësorët, në pjesët më të paarritshme, e kanë ruajtur krishterimin. Shqiptarët, që zunë fushat, e panë se ishte me leverdi të përqafonin myslimanizmin dhe, si kleri mysliman, ashtu dhe ai katolik, ishin të gatshëm të lidheshin bashkë kundër të krishterëve ortodoksë. Shqiptarët e kanë bërë veten aq të nevojshëm për qeverinë osmane, sa që kjo ka qenë e detyruar t'u bënte çfarëdo lëshimi, mjaft që të mos humbiste përkrahjen e tyre. Megjithëse, nuk ka bërë asnjë përpjekje për qytetërimin e tyre, ajo me paturpësi e ka shfrytëzuar ashpërsinë e tyre në luftë dhe në luftë shqiptari mund të jetë jashtëzakonisht i ashpër. Që në krye të herës, ai kurrë nuk ka mësuar ndonjë gjë nga ato që i quan të nevojshme bota e Perëndimit, në shumicën e rasteve kurrë nuk ka kaluar as forma më fillestare e arsimit këtej pari. Myslimanizmin dhe krishterimin ai i përcakton në një mënyrë të veçantë dhe shqiptare. Në zemrën e tij, ai është i ndikuar kryesisht nga be-

* Edhe në atë kohë të krishterët katolikë ishin të kufizuar në Malësi të Veriut; prandaj pohimet që duket sikur kanë të bëjnë me karakterizimin e gjithë shqiptarëve, siç mund të nënkuptohet këtu kur flitet për «Malet e Shqipërisë», duhen kuptuar si të kufizuara vetëm për disa krahina malore.

simet e paragjykimet tradicionale, të cilat janë shumë më të vjetra se sa të dy feve të reja. Ai e ka arritur një lloj lirie, duke u bërë i dobishëm për turkun dhe turku e ka lënë në errësirën më të thellë të barbarisë. Të vetmet shkolla, në këtë vend, janë shkollat e fretërve* austriakë e italianë. Sa për udhëtimin dhe mjetet e transportit, ka të ngjarë që rrugët e sotme të jenë më të këqija sesa kanë qenë në kohën e romakëve. Dhe ky është vendi i vetëm, me popullsinë e të cilit Turqia e quan veten se ka qenë në marrëdhënie «miqësore». Gjendja e vajtueshme e Shqipërisë është një dëshmi kundër «qeverisjes» turke edhe më e fortë sesa gjendja e Maqedonisë. Sot, vendi praktikisht është në gjendje anarkie. Pak ose aspak është bërë në rrugën e zhvillimit, gjakmarrja vepron lirisht dhe burrat vrasin njëri-tjetrin për grindje që janë trashëguar dhe që kanë nisur për arsye të harruara herët në kohë të errëta.

Jeta e njeriut është e lirë, shumë e lirë. I thatë e i thantë, gjithë muskuj të fortë dhe i shkathët si panterë, shqiptari ecën me hap të gjatë e të lehtë, pa bërë zhurmë, sepse në këmbë ka opinga lëkure të butë, të cilat i puthiten shkëmbit, kur ai ngjitet lart. Ai është i armatosur rëndë dhe, ndërsa ecën, sytë e tij të mprehtë vëzhgojnë paprerë për të gjetur armikun, që gjithmonë pret ta ndeshë. Nuk ka gjë më karakteristike për banorin e fiseve malësore, sesa këta sy që hetojnë gjithçka. E kam takuar atë shpesh në tregjet e Malit të Zi, në ditën e përjavshme të pazarit, në kryeqytetin e vet dhe, duke ecur me pushkë gjithnjë të gatshëm, tutje larg në viset e tij. Kur ngjitet përpjetë ose kur zbret tatëpjetë, nëpër shtigje, që janë më tepër shtretër përrenjsh të thatë, ai është kurdoherë njësoj: ka një hap të shpejtë e të njëtrajtshëm dhe gjithë kohën heton me sy. I veshur siç është me tirqit e ngushtë e me gajtanë dhe me xhurdinë e zezë të shkurtër, ai ka një pamje të jashtëzakonshme mesjetare dhe duket sikur ka dalë drejtpërdrejt nga një afreskë fiorentinase. Brezin e ka ngjeshur me armë të lara me argjend, përdredh mustaqet e kuqërreme dhe e mban veten me të madh. Ai ecën me hap të gjatë sikur rrokulliset, duke e vënë këmbën rrafsh si ndonjë deve ose elefant. Veshja e tij me shirita, që bien në sy, me vija të drejta e të kthyera të gajtanit të zi, të kujton ngjyrat e tigrin, të zebrës dhe të gjarpërinjve të ndryshëm helmues e të insekteve. Duket sikur u nënshtrohet ligjeve që sundojnë ngjyrat e lëkurës së kafshëve

* Që më 1887 në Korçë ishte hapur Mësonjëtorja shqipe, e cila u mbyll me dhunë më 1902 dhe u hap përsëri pak më vonë.

të egra; hapat e tij të shpejtë e të heshtur e zmadhojnë këtë ngjashmëri dhe këto ngjyra janë mbrojtëse, ai zhduket plotësisht nga pamja në një sfond shkëmbor. Zbukurimi me gjatana të zinj ndryshon sipas fisit nga e ka prejardhjen. Po ta pyesësh për emrin, përgjithësisht ai të thotë dhe emrin e fisit të vet dhe të tregon me gisht malësinë në drejtim të krahinës së tij. Për shembull, ai është filani i Hotit ose i Shoshit. Shumë burra, si të krishterë edhe myslimanë, e kanë kokën të rruar, disa herë rruajnë vetëm tëmthat dhe pjesa tjetër e flokëve ngrihet lart si një kaçubë e madhe. Disa herë e kanë të rrojtur gjithë kokën, me përjashtim të një perçeje të gjatë, e cila varet prapa. Ka dy tipa të veçantë të shqiptarëve: një tip zeshkan me flokë të zinj, sy gështenjë e tipare të theksuara, një tip tjetër me flokë mjaft të verdhë, me sy të kaltër ose hiroshë dhe me shtat më të lidhur. Në këtë grup, bëjnë pjesë të gjithë burrat me kokë të rruar e me perçen që u varet pas, kështu, që kur ulen në bisht në një rresht, ngjajnë mjaft me një tufë skifterësh që u kanë rënë pendët përgjysmë. Sipas besimit popullor, perçja e gjatë përdoret si vendi për ta kapur e për ta sjellë në shtëpi kokën, kur ia presin diku. Me sa duket, një kokë mund të mbahet ose nga veshët, ose duke i futur një gisht në gojë dhe prandaj njeriu i gjallë nuk e pranon një gjë të tillë për vete, nëse do t'ia presin kokën ndonjëherë!

Shqiptari nuk është aspak i keq, megjithëse ka mjaft të meta të dukshme dhe pamjen e një egërsire. Madje, do të thosha, se ai ka instinktin e një fisniku. Sidoqoftë, ai është «indershëm» në përputhje me bindjet e veta. Ai krenohet se kurrë nuk ka tradhtuar një mik dhe nuk ka falur një armik. Është e vërtetë që shprehja «nuk ka falur» përfshin edhe mundime e veprime të tjera të tmerrshme, por është gabim i madh të thuash se cilido nga popujt e Ballkanit nxjerr ndonjë gjë të madhe me «mizori». Një shekull më parë, çdo popull, duke përfshirë edhe popullin tonë, e quante një mënyrë të ligjshme për të dënuar krime relativisht të vogla, kur u shkaktonte të dënuarve dhimbje të mëdha. Do ta pranoja që edhe të më qeshnin, por do të them se nuk e besoj që shqiptari është i pamëshirshëm nga natyra. Jeta e malësorit është e rëndë dhe e ashpër shumë më tepër se sa mund ta kuptojë dikush që ka jetuar vetëm në një vend të qytetëruar, kështu që jeta e njerëzve, që ndodhen në këto kushte të egra, është detyruesisht e rëndë. E megjithëse unë e kam takuar atë në kopetë e tij, në shpatet e maleve dhe e kam vëzhguar me kujdes, në rrugë e në pazar, kurrë nuk kam parë një shqiptar që të mendojë një kaf-

shë vetëm për të bërë qejf, siç bëjnë napolitanët, provansalët dhe spanjollët. «Lojërat» e neveritshme me të çalët dhe me kafshët e pambrojtura, që mund t'i shohësh çdo ditë në rrugët e Napolit, nuk ndeshen në kryeqendrën e shqiptarit të quajtur gjakatar.

Më kanë thënë se unë i kam besuar shqiptarit me mendjelehtësi. Unë i kam dhënë atij shumë raste që të më grabiste dhe, disa herë, ka qenë mundësia për të më zhdukur, por ai gjithnjë më ka trajtuar me mirësjellje të hollë dhe nuk ka përfituar as në rastin më të vogël. Ai është burrë trim dhe i zgjuar. Kur i paraqitet mundësia, ai i mëson dhe i kap shpejt gjuhët e huaja. Dhe kur ndodh që e lë vendlindjen dhe shpëton nga atmosfera mbytëse e osmanëve, shpesh ai tregon aftësi të madhe për punë dhe një zotësi të habitshme për t'iu përshtatur rrethanave.

Shqiptari i zakonshëm i krishterë, në qytet, është mjaft i ndryshëm nga malësori i ashpër dhe duket një njeri me tipare feminare patetike. Përpiqet me çmos që të duket i qytetëruar, por idetë e tij për qytetërimin janë të mjegullta. Biseda e mëposhtme tregon se sa larg është ai nga të kuptuarit e paragjykimëve të shekullit të njëzetë. Kjo është një ndodhi nga shumë të tjera të njëllota. Po i ngjitesha rrugës së pjerrët me kalldrëm të pazarit në Tivar, një pasdite vonë, në verë të vitit 1902. Dyqanxhinjtë qëndronin të dyert e më shihnin si po kaloja. Kur më del përpara një djalë i gjatë, flokëverdhe e me sy të hirtë. Fliste me mjaft mirësjellje një përzierje të spanjishtes me italishten. Më tha:

— Unë kurrë nuk kam parë ndonjë grua të huaj deri më sot, a do të pranoni të vinit në dyqanin tim dhe të bisedonim?

Unë e ndoqa në dyqanin e tij. Meqë dukej qartë se unë isha nga Perëndimi, ai më nxori një arkë të vogël që të ulesha dhe u ul shtruar përdhe vetë. Porositi kafën e nisëm bisedën. U habit kur mori vesh, se nga cili vend jam dhe më tregoi lëmsha pambuku me etiketën anglisht «fill i fortë i cilësisë më të mirë», që i kishte ndërmjet mallrave. Por veç kësaj, «Anglia» nuk i sillte gjë tjetër ndër mend. Meqë Anglia nuk ka ndonjë plan kundër Shqipërisë, nuk përfillet edhe aq si Fuqi nga shqiptari i zakonshëm, por është thjesht diçka e largët dhe e padëmshme që nuk hyn në hesap, ndërsa ai i mban sytë hapur kundrejt Austrisë e Italisë, kurse Rusia shihet me dyshimin më të madh.

— Dhe ju keni bërë gjithë këtë rrugë për të na parë! — thirri ai. — Mrekullia vetë! Unë jam shqiptar i krishterë. Jam

katolik. — Ai bëri kryq fort, për të më treguar se ishte vërtet, sepse në këto vende pozita juaj në këtë botë dhe në atë tjetrën varet shumë nga mënyra sesi bën kryqin. — Po ju duhet të shihni Shkodrën!

Unë i thashë se e njihja mirë Shkodrën dhe atij i ndriti fytyra nga kënaqësia. Ne biseduam për bukuritë e saj dhe për dyqanet që nuk ua kalonte asnjë në botë.

— Dhe Shkodra është në duart e atyre dreqërve turq. Ah, ata dreqër! Unë kam ardhur këtu para tetëmbëdhjetë vjetësh me babanë tim, sepse ky vend është çliruar. Këtu je i sigurtë, por është vend i varfër. Kur isha kalama, kam qenë i keq. Shkoja në një shkollë te frati, por nuk kisha ëndje të mësoja. E tashti nuk di asgjë, flas vetëm italisht, po dhe këtë keq fare! — Nisi të tundej me trishtim sa majtas-djathtas me tefterin e madh të hesapeve mbi gjunjë.

Ai u ankua (e kush prej nesh nuk do të ankohej?) se e kishte humbur rastin në djalëri dhe tani nuk dinte të mësonte nga librat. Për ta ngushëlluar, i thashë se bashkatdhetarët e tij në Shkodër ishin sjellë shumë mirë me mua. Ai u gëzua.

— Po pse keni ardhur këtu? — më pyeti. — Pse nuk udhëtoni në vendin tim? — Iu përgjigja se më kishin thënë që ishin kohë të këqija dhe kishte rreziqe të mëdha. Ai e peshoi çështjen thellë dhe më hodhi një vështrim nga koka te këmbët. Pastaj më tha me seriozitet: — Jo, shqiptarët sillen shumë mirë me gratë, ata nuk do t'ju bëjnë asnjë të keqe. Puna është se atje nuk ka qeveri, prandaj njerëzit e ligj bëjnë çfarë të duan. Ka do njerëz të këqinj, janë turq, të gjithë turqit. Por mos kini frikë. Është e vërtetë që do t'ju marrin të gjitha paratë, por nuk do t'ju bëjnë ndonjë të keqe. Kjo, — tha ai thjesht — nuk do të ishte e ndershme. Bashkatdhetarët e mi janë të gjithë të ndershëm. Kundër një gruaje mos qëllo, sepse gruaja nuk mund të qëllojë kundër teje. Kurse me burrin është krejt ndryshe, ose ti e vret atë, ose do të të vrasë ai i pari. E gjithashtu burrit nuk ia merr dot paratë, nëse nuk e vret më parë. — Dhe për të gjitha këto pika unë u pajtova me të.

— Vërtet është fatkeqësi e madhe që nuk ka qeveri atje, — vazhdoi ai. — Sikur të kishim, qoftë një mbret!

— A mendon se do të keni një mbret? — e pyeta unë. Ai seç mërmëriti në mënyrë të fshehtë. Pikërisht, në ato ditë, qarkullonin shumë fjalë për një pasardhës Kastriot të familjes së Skënderbeut dhe kishte njoftime se, në ato çaste, po priste rastin për të zbarkuar në Shqipëri. Lajmet për një pasuri përrallore që na kishte, kishin ngjallur mjaft ngazëllim në gjok-

set e atyre që do të ishin nënshtrësit e tij. Besoj se deri në veshët e tij do të kishte vajtur njoftimi për këtë zakon, që buurrin duhet «ta vrasësh më parë», meqë ai zotni me moshë të mesme, që kishte kaluar jetën nëpër pallatet e Italisë, nuk po tregonte ndonjë ngut për të marrë përsipër trashëgimin. Mendimet e mikut tim ishin të mjegullta e të papërcaktuara dhe ai nuk shkonte përtej fjalëve për «një mbret Shqipërisë dhe vdekje dreqërve të Turqisë». Pasi biseduam edhe ca, u ngrita t'i lija lamtumirën. Por ai nguli këmbë që të pija kafe prapë.

— Është e vërtetë që unë jam i varfër, — më tha, — por nuk jam aq i varfër sa të mos i jap dy kafe një gruaje që ka ardhur nga aq larg, për të na parë. Ndoshta, një ditë, në vendin tuaj ju do të takoni një shejtan të varfër nga Shkodra dhe do ta prisni mirë, sepse njerëzit e tij janë miqtë tuaj. — Nuk ka asgjë që t'ia kalojë hijeshisë, me të cilën ai i tregonte mikpritjen një mysafiri të huaj, e megjithatë nuk kishte asnjë kundërshtim për grabitjen me vrasje, nëse bëhej sipas rregullave, dhe ai krenohej për ndjenjat e veta si i krishterë. Toku dorën me mua shumë përzemërsisht.

— Udhë të mbarë, — më tha. — Më kujtoni mua po takuat ndonjë shkodran në Londër. Unë kurrë s'kam për t'ju parë më, kurrën e kurrës.

Dielli po perëndonte mjaft i zymtë dhe unë e ndjeva veten po aq të trishtuar sa edhe ai shqiptari tek po largohesha me fjalët «kurrën e kurrës», që më tingëllonin në veshë, ndërsa përpara meje shtriheshin rrënojat e errëta të qytetit të vdekur. Është e vërtetë që botëvështrimi i shqiptarit nuk është gazmor.

Në qytetet e mëdha, ku janë vendosur trupat turke dhe ka shumë nëpunës myslimanë, të krishterët janë pakicë dhe qëndrimet e tyre të ndrojtura tregojnë fare qartë se ata nuk ia çojnë mirë. Por, të krishterët e malësive mbahen fort pas të vetes. Fisi i Mirditës, në malësitë ndërmjet Drinit dhe bregdetit, është i gjithë i krishterë dhe një nga fiset e pavarura, që mbahet më i pamposhtur. Ndonjë i krishterë nga qyteti, i cili ka marrë pak arsim të sipërfaqshëm nga frati i huaj, që ka hedhur një sy në botën e jashtme dhe që ka një ide të turbullt për të mirat e jetës në një vend të qeverisur mirë, edhe psherëtin për ndonjë formë qeverimi të qytetëruar. Madje, ndonjëri më ka thënë se dëshironte që «t'i merrte» dikush, «qoftë kushdo, Austria ose Italia, edhe ju apo dikush tjetër. Më keq se është tani gjendja nuk mund të bëhet dot». Por masa e popullit e kundërshton me ashpërsinë më të madhe idenë për çfarëdo

ndërhyrje të huaj, duke iu mbajtur fort mënyrave të veta të jetës tradicionale e të pakultivuar. Qoftë i krishterë, qoftë mysliman shqiptari është me gjithë shpirt shqiptar. Një i krishterë mund të të njohë me një mysliman dhe të thotë: «Ai është turk*, por nuk është turk i keq, sepse është i mirë njësoj si unë, është shqiptar.» Të krishterët që i ndjek myslimani shqiptar, si rregull, janë të krishterë të një kombësie tjetër. Ka mjaft grindje ndërmjet shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë, por po ashtu ka edhe ndërmjet të krishterit me të krishterin dhe myslimanit me myslimanin. Kjo vjen nga gjakmarrja, që ndodh midis fiseve dhe që u nënshtrohet rregullave, sepse edhe në Shqipëri është e mundur që, nëse nuk zbatohen rregullat, ai që vret një njeri të trajtohet si vrasës. Kur shqiptarët i kërcënon një armik i përbashkët, shpallet «besa» (fjala e dhënë për paqe midis tyre) dhe ata bashkohen kundër tij. Në pjesën më veriore të Shqipërisë, fiset më kryesore janë: Hoti, gjatë kufirit me Malin e Zi dhe buzë liqenit, Shoshi dhe njerëzit e Shalës e të Shkrelit, në malësitë mbi fushën e Shkodrës, mirditorët, në malësinë ndërmjet Drinit e bregdetit, dhe kelmendasit, në kufirin me Malin e Zi, nga Mokra dhe Andrijevisa.

Kur shqiptarët ngrenë krye më shumë se zakonisht, turqit herë pas here me mjete të ndryshme, duke përfshirë edhe tradhtinë, ia kanë dalë që krerëve të tyre t'u japin ndonjë «vend» në qoshet e humbura të Azisë së Vogël, por nuk kanë arritur ndonjë rezultat, madje malësorët, duke mos pasur të vetmin njeri, që ka autoritet mbi ta, janë bërë edhe më të pashtuar. Madje, edhe krishterët më të shtruar, në qytet, kanë kënaqësi të tregojnë në pazar duhanin, për të cilin nuk kanë paguar taksë, dhe thonë: «Ne nuk paguajmë taksë për duhanin, ne jemi shqiptarë dhe nuk na pëlqejnë këto gjëra». Turqit nuk kanë qenë në gjendje që t'ua merrnin këtë taksë dhe janë të detyruar të kënaqen, duke kontrolluar mallrat, që nxirren jashtë vendit dhe plaçkat e dorës të turistëve, për të ndaluar që duhani të nxirret jashtë pa taksë doganore.

Rrallë pranojnë shqiptarët të bëjnë diçka që «nuk u pëlqen» dhe kundërshtojnë menjëherë për çdo ndërhyrje. Tashti, së fundi, kanë kundërshtuar për «reformat» sipas mënyrave austro-ruse. Kur isha në këto vise, verën e vitit të kaluar, të gjithë talleshin me këto të ashtuquajtura reforma: serbët, malazeztë dhe shqiptarët. Turqve u ka pëlqyer gjithnjë «mosreformizmi» i shqiptarit. Për t'i dhënë mundësi të plotë që të

* Në këtë rast do të thotë se është i fesë myslimane.

sillet në mënyrë «joreformiste», ku e shtynte shpirti i vet, turqit e furnizuan bujarisht me armë, duke i shprehur mirë-tha vendet e pushtuara nga turqit, kurdoherë ka qenë e ndashqiptar e ka pasur këtë privilegj. Çdo malësor ka një armë zjarri, disa kanë pushkë mjaft moderne. Tjetër gjë është t'ia japësh një burri një armë dhe krejt tjetër është t'ia marrësh. Kur armët përdorëshin thjesht kundër fshatarëve të paarmatosur serbë, në fushën e Serbisë së vjetër, me përjashtim tani të Rusisë, asnjë shpirt i gjallë, në asnjë vend të Evropës, nuk u ndie. Por kur Serbia, konsulli rus, ra viktimë, na doli ndryshe puna dhe turqit u ndodhën në pozitën më të pakëndshme, sepse u duhej ose të fyenin Rusinë, ose të grindeshin me aleatët e vet më të mirë. Ata nisën që të bënin «reforma», në Shqipëri, sipas mënyrës së vërtetë turkoshake. Ata i dëbuan shqiptarët nga trojet, të cilat nuk kishin ndonjë punë që t'i mbanin dhe, sa për formë, arrestuan disa nga krerët e tyre. Shqiptarët nuk e prisnin këtë dhe u zemëruan mjaft, sepse ata nuk kishin bërë ndonjë gjë më tepër, se sa ajo, që u ishte bërë e nënkuptuar se mund ta bënin. Ndërhyrjet e mëtejshme do t'i kishin larguar më keq shqiptarët, por për të ruajtur fytyrën dhe për hir të «planit të reformës», u desh të caktoeshin ca zyrtarë jomyslimanë. Kështu, turqit dërguan në Shkodër një armen dhe një çifut, që quheshin njëri Isak e tjetri Jakov. Në rrugën kryesore dhe në mes të ditës Isaku me Jakovin u vranë dhe, me sa di unë, vendet e tyre ende janë të pazëna. Çështja ngjalli një lloj turbullire, megjithatë, shqiptarët nuk kanë dëshirë të përdorin dhunën, përderisa «qeveria» të mos bëhet e padurueshme. Pak kohë, pasi u vranë Isaku e Jakovi, u gjetën ca shkrime të mistershme mbi një varr. Ishin shkruar me qymyr të zakonshëm, por dukej qartë se qenkeshin me prejardhje pak a shumë hyjnore dhe njerëzit mezi prisnin që të lexohej çfarë thuhej. Na doli se ishte thjesht një verset nga kurani, që fliste për bekimin për dikë. «Allahu qoftë lëvduar, — tha një hoxhë plak, — ai nuk na ka porositur që të vrasim ndonjë reformator tjetër!»

Në Shkodër kishte ushtarë shumë më tepër se sa herë tjetër. Unë pyeta cili ishte shkaku, me qëllim që të shihja se çfarë do të thoshin. Që të gjithë më thoshin me të qeshur: «Turqit duan të bëjnë reforma në Shqipëri, por janë të detyruar t'i dërgojnë ushtarët nëpër qytete, sepse banorët e fshatrave nuk i kanë qejf!». Qyteti gëlonte nga ushtarët. Një ofi-

cer iu sul udhërrëfyesit tim të vjetër, që e mbaja për të më përkthyer në pazar, dhe i foli keq me zë të lartë, derisa ndërhyra unë. Një ushtar kapi e rrahu keq një djalë të mjerë, që po më lypte diçka, dhe nuk bënë dobi as përpjekjet e mia për ta shpëtuar. Ja, këto ishin të gjitha rezultatet e reformave, me sa kam parë e kam dëgjuar unë në Shkodër.

Me sa duket, po fiton truall ideja se, në rast të një lufte, shqiptari nuk do të përkrahë më një çështje të vdekur dhe do të zgjedhë rrugën për të ndjekur qëllimet e veta. Kur Maqedonia do të ketë një qeveritar të krishterë, gjë që do të ndodhë patjetër së shpejti, Shqipëria do të jetë më e shkëputur nga qendra e sotme e qeverisë (Stambolli) dhe gjendja do të bëhet më e acaruar. Kam dëgjuar mjaft fjalë për «mbretin që do të bëhet». Madje edhe disa serbë kanë shprehur mendimin se shqiptarët do të bëhen shumë më të mirë nëse do t'u njihet pavarësia, duke thënë se tani ata nuk janë përgjegjës para askujt, janë turqit që i nxisin për të bërë veprime të dhunshme dhe pastaj i lajnë duart për vete nga gjithçka, por po të lieshin të lirë për vete, shqiptarët do të zhvilloheshin si një popull shumë i mirë. Që ata i kanë të dhënat, për të qenë një popull shumë i mirë, kjo, me sa duket, është e vërtetë. Është tjetër gjë se sa janë ata tani të aftë për vetëqeverisje. Ndryshe nga popujt e tjerë të Ballkanit, ata nuk kanë patur në të kaluarën, ndonjë perandori. Historia e tyre janë «vite që i kanë brejtur karkalecat». Çfarë do të bëhet me shqiptarët? — kjo është një nga pyetjet më të vështira ndër çështjet e Lindjes. Ndërsa Austria kërkon ta japë ajo përgjigjen.

KREU II

SHKODRA

Shkodra është kryeqendra e Shqipërisë së Veriut. Në hartat tona, ajo shkruhet Scutari dhe ky emër shkakton që të ngatërrrohet me Skutarin e Bosforit, që është shumë më i njohur. Një herë kam lexuar, në një gazetë franceze, një njoftim për «Princin e pallatit të Malit të Zi në Bosfor», që e përshkruante vendin e princit në Podgoricë, pranë liqenit të Shkodrës. Por francezët rrallë kanë shkëlqyer si gjeografë.

Në Shkodër mund të shkosh nga porti i Shëngjinit, ku ndalon rregullisht një anije e linjës së firmës Llojd. Po të mund të gjeni një kalë, që atje duhet të bëni nëntë orë udhëtim nëpër një rrugë shumë të keqe për të arritur në qytet. Madje edhe nga turqit, të cilët japin një pamje *couleur de rose** për vendet që kanë zënë, nuk kanë mundur të më tregojnë ndonjë gjë tërheqëse gjatë kësaj rruge. Në Shkodër, mund të shkosh edhe me anijen që ngjitet nëpër Bunë deri në Obot, kur ka mjaft ujë lumi, kurse nga Oboti një barkë, duke u lëkundur do t'ju çojë në qytet për rreth një orë.

Një rrugë shumë më e mirë dhe më e këndshme është ajo nëpër liqen, duke u nisur nga Cetinia. Barka Danitza, të cilën inxhinieri e quan anijen kryesore të skuadrës detare të Malit të Zi, e bën rrugën nga Rijeka dy herë në javë. Është një anije e vogël, e pastër, e rregullt, është ndërtuar në Glasgou dhe është shumë e përpiktë. Rryma e ngadaltë dredhon, duke hyrë e dalë midis kodrave, kanali i ujërave të thella gjarpëron midis sipërfaqeve të tëra me zambakë uji të bardhë e të verdhë, gjethet e të cilëve formojnë një shtresë të dendur, në sipërfaqe, dhe janë një truall shumë i volitshëm giahu për zogjtë e ujit: rosat, thëllëzat, çafkat, sqeplugat dhe pelikanët. Ky është një

* Fr. pamje me ngjyrë trëndafili, pra e zbukuruar, jo e vërtetë.

lumë zanash me magjinë e kodrave përsipër, krejt i qetë, me përjashtim të përplasjes së flatrave të zogjve që ngrihen, kur barka u kalon pranë.

Te gryka e lumit, ka disa kasolle të mjera prej gurësh e shkurresh, që janë banesa të peshkatarëve, të cilët kanë të vjela të mbara në vjeshtën e vonë. Tufa të mëdha të një peshku të vogël, që e quajnë «skort», çajnë lart, drejt liqenit nga deti, dhe i kapin me aq shumicë, saqë, të tharë e të kripur, përbëjnë një nga eksportet kryesore të Malit të Zi.

Ne kalojmë ishullin e Vraninës dhe rrëshqasim në liqenin e madh ngjyrë bari, duke i lënë pas lartësitë e Malit të Zi dhe në skajin tjetër shohim «Bjeshkët e Namuna» të Shqipërisë, që duken të kuqërreme në largësi. Siç thonë shqiptarët, ujërat e liqenit kanë veti mjekuese të mrekullueshme. Duhet të pish nga ky ujë për një muaj rresht dhe çfarëdo që të ketë qenë sëmundja juaj, ose «e nxjerr përjashta të gjithë» ose vdes! Është një mjet i ashpër për t'u shëruar ose për të vdekur, por që unë për vete kurrë nuk e kam provuar. Ndalojmë në Plavnicë dhe në Virpazar, për të marrë udhëtarë që vijnë me barka të mëdha, të cilat kanë bash të gjatë e të përkulur poshtë. Kuverta e anijes mbushet me plaçka lloj-llojesh dhe me të zotërit e tyre të çuditshëm, që janë zakonisht të dëshiruar për të zënë miq. Mjafton të tregoni pak interes për foshnjat e grave dhe për armët e burrave dhe kështu e keni të siguruar argëtimin për gjithë udhëtimin e mëtejshëm. Një shqiptar i gjatë i tha një të riu:

— Tregoja zonjës armën tënde të re. — Ai më kaloi një pushkë ruse me rimbushje. Një grua, që po vinte aty afër, u hoq mënjanë me shpejtësi. Shqiptari i foli me shpërfillje.

— Po mund të bjerë, — tha gruaja.

— E pastaj se do të bjerë? — qeshi shqiptari. — Pa më shiko mua. Dy herë më kanë qëlluar. Nuk është gjë e madhe. Një herë më kanë goditur mu këtu, — ai preku supin, — dhe doktori ma nxori plumbin me një thikë, — shtoi ai me një kënaqësi të madhe.

— Mua më është vrarë vëllai, — ia preu gruaja shkurt.

Kështu, duke lundruar me nge deri në fund të liqenit, ne shohim një gjysmëhënë që fluturon mbi një anije lufte të vjetruar, është një flamur i kuq dhe një hënë e ngrënë, të cilën ne gabimisht e quajmë «hënë e re» këtë gjysmëhënë, e cila kurrë nuk ka për t'u mbushur përsëri. Më duhet ta them se, nëpër anije, unë kurrë nuk e shoh atë pa një drithmë të çuditshme. Unë jam edukuar që ta shoh turkun si një njeri shumë të virtyt-

shëm dhe që e kanë lënduar fort. Ndërsa tani, unë kurrë nuk i kapërcej kufijtë e tij pa shpresën se do të kem mundësinë të jem dëshmitare e largimit të tij nga Evropa.

Një kështjellë e rrënuar na sheh shtrembër nga një kodër, një radhë ndërtesash të vjetruara shtrihen gjatë bregut, një turmë e dendur ka zënë shkallët e doganës. Më në fund, arrijmë në Shkodër, aty shkruhet: Scutari-Albanese.* Koha kërcen mbrapsht nga një ledh i padukshëm, të cilin shekujt e kanë rrahur pa dobi dhe para nesh shtrihen viset e një populli parahistorik dhe jeta e kohëve të shkuara. Barka të vogla e të mëdha venë e vinë rrëmujë, duke u llapashitur. Mali i Zi mbetet për ca kohë si tipi i gjithçkaje që është e qytetëruar në Evropën Perëndimore dhe ne e lëmë prapa me avulloren.

Dogana është një strofull e errët, ku të gjithë i bërtasin njëri-tjetrit dhe ngatërrohen me të gjithë. Në rast se keni ndonjë fjalor, fshiheni në një xhep të brendshëm, sepse turku thotë që kushedi se çfarë gjërash mund të ketë brenda një libër i huaj, prandaj më mirë t'i flakin të gjithë. Nuk ka gjë më të rrezikshme për ta. Pasaportat i kërkojnë ose nuk i kërkojnë, kjo varet nga shkalla e tensionit politik. Kam dëgjuar për dy veta që e «kanë hedhur» këtë kufi duke treguar fatura, të cilave u jepte një pamje mjaft zyrtare prania e pullave të taksës, ndërsa unë vetë e kam kaluar kufirin turk dy herë kur «më ishte ndaluar». Besoj, këtë mund ta bëjë kushdo me dy para mend. Vërtet duhet thënë diçka për këtë sistem pasaportash, i cili është vendosur për të penguar vetëm budallenjtë. Një persian, që na kontrolloi pasaportat, në këtë rast thjesht na pyeti për emrat, por ata ishin shumë të vështirë për të. Ne i dhamë kartëvizitat tona, ai na i kopjoi emrat shkronjë për shkronjë dhe, meqë u lodh nga ky mundim, na shtoi nga pas «Londër» si një adresë të mjaftueshme dhe kështu përfundoi gjithë ceremonia. Ishte një djalosh i përunjur, i cili do të pranonte dy grosh si bakshish dhe që do të bëhej si qen besnik po t'i jepje një flori. Unë besoj se ai, ashtu si shumica e nëpunësve turq, mbahej me ato që nxirrte nga zyra. Dhe kombi, që ai do më shumë në gjithë Evropën, varet nga kombësia e njeriut me të cilin ai ka të bëjë atë çast.

Pasi arrin në Shkodër, njeriu mësohet, siç mësohet me shumë gjera të tjera, por vizita e parë është shumë argëtuese. Do të kalojë ca kohë, derisa unë ta harroj atë ditë, kur dolëm për herë të parë nga ajo doganë. Kapiteni i avullores i dëboi me

* It. Shkodra e Shqipërisë.

shkelma gjithë ata që u afruan si hamej, me përjashtim të një djali të vogël dhe i tha të na çonte te vendi i karrocave. Djali vrapoi si lepur, duke përshkuar labirintin e rrugëve të pazarit, duke dredhuar rreth qosheve e duke u zhytur nëpër rrugica të errëta e pa ajër, ndërsa këmbët e zbathura fërkoheshin për tokë. Ne mezi e ndiqnim pas të verbuar nga dielli i fortë në disa vende dhe nga errësira në të tjera, të turbulluar nga pamjet e pazakonshme dhe duke shkarë nëpër gurët rrëshqitës të kalldrëmit, që zbret i pjerrët deri në mes, ku është kanali për ujërat e ku ecin kafshët e barrës dhe grumbullohet plehu. Pas nja dhjetë minutash vrapimi, më në fund ndalëm pa frymë në një shesh të hapur, në skajin e përtejme të pazarit, u rrasëm në një karrocë ngjyrë bizeleje të hapur dhe pranuan të paguanim me mirënjohje gjashtë peni. U nisëm me krakëllimë teposhtë një rrugice, e cila, po të mos ishin tjetër lloj kalimtarët, do të dukej si ato të Anglisë, kaq të njohura dukeshin gardhet, hendeqet, drizat e kulprat dhe për njëzet minuta arritëm lagjet e banuara të qytetit dhe një bujtinë të pëlqyeshme.

Shkodra nuk është thjesht një pikë interesante që e vlen ta vizitosh nga Cetinja, ajo ka të bëjë edhe me historinë serbe. Që në një periudhë të hershme thuhet se, nga shekulli i shtatë, ajo u përfshi në territoret serbe* dhe nuk u pushtua nga osmanët as pas betejës fatale të Kosovës. Ajo ka qenë kryeqyteti i Gjergj Balshës, princit të Zetës** dhe ai ua la në dorë jo turqve, po venedikasve, nga të cilët kanë mbetur gjurmë të arkitekturës ende sot. Megjithëse e sulmuan disa herë, osmanët e morën vetëm më 1479, por edhe atëherë, pas një rrethimi prej gjashtë muajsh. Tashti turqit e kanë pushtuar Shkodrën, shqiptarët e kanë të vetën, kurse malaziasit nuk e ka harruar se, një herë e një kohë, ajo ka qenë nën Perandorinë e madhe Serbe. Sipas mendimit të shqiptarit, ky është qyteti më i bukur në Evropë dhe, kur të thotë këtë, ai beson se kjo është e vërtetë fjalë për

* Shkodra u pushtua nga serbët më 1040. Autorja do t'i kushtojë asaj më 1914 librin «Lufta për Shkodrën».

** Me emrin Zeta që nga shek. XIII njihen viset nga Budua deri në derdhjen e Bunës, që më parë i përfshinte Dioklea. Në shek. XIV-XV me formimin e principatës shqiptare të Balshajve, emri i Zetës përfshihet në emërtimin më të përgjithshëm të Shqipërisë (Albania), ndërsa vetëm gjatë sundimit osman një pjesë e kësaj zone mori emrin Mati i Zi.

fjalë. Për të, ky është një vend ideal, një model sesi duhet të jetë një kryeqytet dhe qendra e universit të tij.

Shqiptari mund të kapet i ri e të zbutet, ai mund të endet në vende shumë të largëta, ai bën tregti të mirë në Romë, ai madje mund të jetojë për mjaft vjet në Angli, por për të lavdia është vetëm në kryeqytetin e vendit të tij. Atë rrallë e ndesh në Londër, janë vetëm nja dy a tre dhe është vështirë t'i gjesh. Unë i gjurmova në një nga rrethinat dhe, kur e morën vesh se nga kisha ardhur, i pushtoi një entuziazëm i pakufi. Madhëshia dhe shkëlqimi i atdheut të tyre nuk i bënte aspak të çuditëshin që e gjithë Evropa e lakmonte dhe kjo i mbushte me ndjenjë krenarie.

— As Rusia, as Austria, asnjë prej tyre, — më tha njëri me një italishte të çalë, — nuk do të na e marrin! Anglezët janë budallenj, nuk e kuptojnë popullin tim. Populli ynë për një javë është kështu, — dhe ai rrotulloi me furi krahët rreth kokës, — kurse javës tjetër shkon përsëri në punë. Bukur. Luftë me turqit? Nuk ka për t'u bërë.

— A nuk është i rëndë sundimi i qeverisë turke? — e pyeta.

— Atje nuk ka fare qeveri, — m'u përgjigj me hare.

— Po puna e taksave si është?

— Pse duhet t'i paguajmë? — tha shqiptari i zbutur, — pa ma shpjegoni ju.

Ai e pranonte, që kohë pas kohe, duheshin mbledhur para, por njeriu gjithnjë rron me shpresë se do t'i mbledhin taksat në një krahinë tjetër dhe po të kishe ca shpresa, ashtu do të ndodhte. Kur kishte qenë i ri, ai kishte luftuar për turqit.

— Kam qenë bashibuzuk, — tha jo pa krenari. — Në ushtrinë e rregullt janë të gjithë myslimanë. Unë jam katolik. Jam i krishterë i mirë. Jam bashibuzuk.

Të merresh me bashibuzukllëk dhe të jesh i krishterë janë dy gjëra mjaft larg njëra-tjetrës, por për të dukeshin në rregull e pajtoheshin.

Ai ishte në krye të një tregtie të lulëzuar në Londër dhe ishte i veshur me një pardesy të modës e në kokë kishte një cilindër, por ishte ulur këmbëkryq në dysheme dhe i ndritën sytë, kur iu kujtuan ditët e hershme si bashibuzuk. Në Londër kishte ardhur sepse, siç e di kushdo, «ka shumë para në Londër». Ai nuk dinte asnjë fjalë anglisht dhe vetëm pak italisht, atëherë pothuaj ishte pa para dhe gjithë mallrat që kishte për tregti ishin gjithsej disa kostume kombëtare dhe disa punime argjendi në filigram. Dukej se do të dështonte pa asnjë shpëtim,

por guximi dhe shpirti tregtar të ish-bashibuzukut i kapërcyen të gjitha vështirësitë.

— Ju mendoni se atdheu im është një vend i egër, — më tha, — tani po ju flas unë për Londrën. Ky është një qytet i madh e i keq. Ka pesë milionë veta në Londër. O zot, sa shumë kriminelë që ka! Në atdheun tim nuk vdes njeri për bukë. Kushdo mund të trokasë në një derë. «Çfarë do?». «Jam i uritur.» «Bukur fort, hyr brenda». I japin bukë, i qesin verë. Kurse në Londër ju thoni: «Qërohu ose thirra policin». Kurdoherë që një shqiptar i krishterë është në nevojë, mjafton që të trokasë në derën e një shqiptari të krishterë dhe t'i qajë hallin. As që mendon njeri se duhet ta paguash pastaj.

— Si mund të jetojmë, — më pat thënë njëri, — në rast se nuk e ndihmojmë njeri tjetrin? — Edhe tani, në sytë e një ish-bashibuzuku, Londra e krahasuar me Shqipërinë është një vend i madh, i egër e i paqytetëruar. Dhe ndoshta ai ka të drejtë. E megjithatë, ai ka gjetur aty një vend të shkëlqyer për të ecur përpara. E shoqja, «zonja ime shqiptare» siç e quante, ia kalonte mjaft keq, siç ma pranoi vetë. Ajo nuk dinte gjuhë tjetër veç shqipes, gjithmonë psherëtinte për diellin dhe për brigjet e liqenit të Shkodrës dhe gati sa nuk ia dha vajit, kur dëgjoi se unë sapo kisha ardhur nga ato vende të dashura. Ajo mbante një kësulë të kuqe me monedha rreth e rrotull dhe një medalion i varej në lule të ballit. Ajo nuk shkonte fare me atë pjesë të pasme të një dyqani në Londër.

— O zot, — më tha shkarazi i shoqi, — më vjen keq për këtë grua të shkretë! — E megjithëse këtë e tha me një ton gazmor, ai kishte një lloj simpatie për të.

«Malli për dheun», dëshira e pashuar për një copë tokë të veçantë, një copë që arsyeja mund të ta tregojë se është shterpë, e thatë, e vetmuar dhe që në çdo pikëpamje nuk të ngjall dashuri, por që megjithatë është djepi i asaj popullsie dhe prandaj është e, ndoshta, ka për të mbetur një nga pasionet njerëzore më të pamposhtura. Ky shqiptar i zbutur ka ndër mend që t'i mbyllë ditët e veta në «qytetin më të bukur të Evropës, në Shkodër».

Qyteti i Shkodrës nuk është në një vend me klimë të shëndetshme. Në verë të zihet fryma edhe në dimër përmbytet nga ujërat. Është në një truall të ulët dhe vuan nga shirat e rënda. E vetmja meritë është se nuk ka mushkonja, por nga ana tjetër e ka mbuluar tuberkulozi. E megjithatë të nxit përfytyrimin, të ngjall herë këtu e herë atje shpirtin e fjetur të një stërgjyshi, që ka vdekur prej kohësh, e pastaj të një tjetri, që

ka jetuar në mesjetën e mjeruar e të shkëlqyer, madje edhe më parë. Këta shpirtra të tregojnë rrugën dhe të pëshpërisin: «Ne kemi bërë këtë dhe atë, po edhe kështu, a nuk e mban mend?» dhe gjëra të çuditshme, të cilat nuk i ke parë asnjëherë, ose diçka shumë e ngjashme me to, ka qenë pjesë e jetës së përditshme të dikujt.

Në pazarin poshtë lumit, në labirintin e rrugicave të ngushta e të përdredhura, me dyqanet prej dërrasash dhe me kall-drëmin e keq, jeta rrjedh siç ka qenë dikur edhe te ne. Secila tregti ka lagjen e vet, ashtu si në gjithë pazaret e Lindjes. Po kështu, rrugët e ngushta në shumë qytete të Anglisë, që mbajnë emrat Rruga e Mëndafshnave, Rreshti i Kasapëve, Rruga e Argjendarëve, ende sot na rrëfejnë për ato kohë, kur, po kështu, ka qenë edhe në Angli, në ato vise, kur druri ishte po kaq i lirë, rrugët po kaq të ngushta e të përdredhura dhe trotuarët po aq të këqinj sa janë sot në Shkodër. Dhe në Angli, atëherë, ashtu si tani në Shkodër, njerëzit mbanin rroba me ngjyra të ndryshme: të kuqe, blu, të gjelbra, të verdha, ndërsa ata, që kishin mundësi, edhe i zbukuronin me qëndisma. Kërkesat e tyre ishin të pakta, nuk kishte kushedi çfarë sendesh luksi për të blerë dhe, prandaj, gjithë gjërat e mira, që kishin, i mbanin veshur dhe shkëlqenin me ar e me stoli në ditët e shënuara e në festa. Po kështu vijon të bëjë Shkodra dhe kështu dalin në rrugë çdo fshatar e shumë fisnikë, në gadishullin Ballkanik të sotëm, që është i botës së vjetër. Janë zbukurime gjithë stoli të bëra që të rrojnë, sepse ato nuk do të dalin nga moda stinën tjetër, as edhe në stinën e vitit tjetër, madje asnjëherë, derisa Shqipëria të «qytetërohet», e kur do të ndodhë kjo? Prandaj stolitë punohen që të rrojnë dhe mbahen e mbahen, deri sa të katandisen në Pazarin e plaçkave, ku i blejnë njerëzit më të varfër. Dhe kur qëndismat fërrohen shpejt nga fërkimi gjatë viteve, përsëri rroba mbahet ende dhe e veshin deri sa të grihet e të bëhet një pështjellim leckash të ndyra. Të gjitha këto veshje të zbukuruar, sado të shkëlqyera nga jashtë, janë të bëra me pëlhura të trasha, shpesh prej pjesësh që nuk përputhen mirë njëra me tjetrën, sepse përfytyrimi i shqiptarit për veshjen është i kohëve të vjetra. Rrobaqepësia e sotme ka shpikur veshje prej pambuku e liri, me mëndafsh ose saten. Mirëpo, edhe paraardhësit e saj kanë punuar ashtu si dhe shqiptarët, prandaj kostumet e bukura prej mëndafshi e me ibërshim, që na kanë ardhur nga koha e Elizabetës dhe e Karlit I, janë të bëra brenda me kana-vacë të trashë e jo të bukur.

Afër hyrjes së pazarit, janë punishtet e zdrukthtarëve, të cilët bëjnë dhe gdhendin arka të mëdha për të mbajtur plaçkat, orendi të lyera me lale e me lule ngjyrë bizele e të zbukuruara me të kuq e ngjyrë ari, që janë pasardhëse të zvetënuara të arkave të gdhendura bukur e të pikturuara, në të cilat e gjithë Evropa i ka mbajtur rrobat në kohën e artit gotik dhe të Rilindjes. Arkapunuesit, po ashtu, bëjnë djepe të mrekullueshme, të ngjyera po me ato bojëra të ndezura dhe aty lidhin foshnjat e i varin në samarët e kafshëve ose i mbajnë gratë në kurriz. Në një vend, ku udhëtimi është i vështirë, del i domosdoshëm një djep i fortë, në të cilin të lidhet foshnja dhe, pa dyshim, stërgjyshët tanë kanë përdorur ato djepe të forta lisi, që ne i njohim aq mirë të po këtij lloji. Çdo ditë në pazar është interesante, sepse pothuaj të gjithë dyqanxhinjtë i bëjnë vetë, si zanatçinj, mallrat. Armëtarët, gjithë ditën, mbushin gëzhojat e fishekëve, sepse janë një mall shumë i kërkuar, ndreqin pushkët e pisqollat dhe armëve moderne u vënë qyta të vjetra të punuara me argjend, që janë gjithë zbukurime me gurë bronzi ose korneliani. Argjendari shtrohet këmbëkryq përdhe me një mangall me prush, me disa masha përpara, me një rrotull teli prej argjendi dhe me një kuti të vogël plot me rruaza prej argjendi. Ai punon i heshtur, ngadalë, me gishtat e gjatë e të shkathët kap rruazat e vockla dhe i vë si duhet, pret e përdredh copa të vogla teli, ngjit me aftësi të madhe dhe ndërton figura shumë të efektshme, të cilat i kanë anët të përputhura, por që nuk janë asnjëherë plotësisht simetrike, ashtu siç është vetë puna e Natyrës dhe e kënaqin syrin në një mënyrë të atillë, që kurrë nuk mund ta bëjë një send i prodhuar me makinë. Sado e trashë të jetë mjeshtëria e tij, ideja e tij është gjithmonë e mirë dhe ai nxjerr efekte të guximshme me gurë xhami si rubinë dhe smeralde të përmasave të mëdha. Shqiptari shkëlqen në punime të tilla. Kur vjen puna për të ndërtuar diçka më të madhe, mjeshtëria e tij, për të punuar me sy e për të gjetur baraspeshimin me instinkt, nuk ka aq shumë sukses. dhomat i ka të shtrembra dhe shtëpitë i dalin jashtë këndit të drejtë. Ndoshta, ky është fryti i pashmangshëm i një mendjeje me prirje të veçantë. Thuhet, se në Shkodër mund të gjesh dhoma me tre mure për arsyen e thjeshtë, sepse muratorët, duke i ngatërruar keqas këndet, nuk ia kanë dalë që të lënë vend për murin e katërt.

Këta artizanë tregtarë, të Shkodrës, janë një bashkësi e ndershme dhe e sjellshme. Nëse paratë tuaja, ndoshta, do të fluturojnë nga një dorë në tjetrën dhe do të zhduken përtej

qoshes, gjithmonë kusuri do t'ju vijë mbrapsht, në fund gjithmonë në rregull dhe ju e kaloni atë copëherë duke pirë një kafe me të zotin e dyqanit. Nëse do të blini mjaft gjëra, ai me mirësjellje do të dërgojë dikë të blejë një copë muslini të zakonshëm, për t'i mbështjellë gjërat, sepse në Shkodër nuk gjen letër dhe, prandaj, kur e blen diçka, sesi do ta çosh në shtëpi është puna jote. Ne, në Londër, jemi të mësuar që të na japin letër, e cila përfshihet falas bashkë me mallin, por një grua plakë më ka thënë një herë se, kur ishte e re, shitësit e dyqaneve të modës për pëlhura në Londër, u jepnin bohçe prej liri atyre që blinin me shumicë dhe këto bohçe pastaj i kthenin të nesërmen. Në këtë hollësi Shkodra nuk është më shumë se tetëdhjetë-nëntëdhjetë vjet prapa Londrës.

Për ta parë pazarin, në gjithë madhësinë e tij, duhet ta vizitosh një ditë të mërkurë, kur është «ditë pazari» dhe mbli-dhen gjithë banorët e fshatrave përreth. Shumë herë, serbët, malazeztë dhe shqiptarët më kanë pyetur: «Cila është dita e pazarit në Londër?» Dhe e vetmja gjë që u jep atyre ndonjë përfytyrim se sa e madhe është Londra, është përgjigja ime: «Çdo ditë në Londër është ditë pazari». Të gjitha gjërat e tjera, si pesë milionë banorë, trenat, dritat elektrike e kështu me radhë nuk i kap mendja e tyre, kurse thënia «ditë pazari çdo ditë» i huton e i mahnit, duke u ngjallur menjëherë pamjen e turmave të mëdha dhe të pasurisë pa fund. «Ditën e pazarit», Shkodra mbushet me njerëz të çuditshëm me veshje ekstravagante, groteske, të përçuda e të mrekullueshme, ndërsa rruga, që herët, është e dendur me kope, me kafshë barre e me të zotët e tyre. Kopetë janë po aq të veçanta sa edhe barinjët e tyre, sepse dashi përçor i dhenve, shpesh, është i lyer me këna të çelët, kurse brirët në vend që t'i përdridhen pranë dy anëve të kokës, janë trajtuar që të qëndrojnë lart si të antilopave dhe, kështu, përdredhja e ngushtë i ka bërë si një spirale të gjatë të tërhequr. Kjo mënyrë është madje edhe më e vjetër sesa pamja e të zotit, sepse ne e ndeshim dashin me këtë trajtim të kokës, në afreskat e hershme të Egjiptit. Për disa nga këta njerëz duhet një shtegtim prej tri e madje deri katër ditë, që të vijnë në treg nga banat e tyre në malësi, kurse gratë nëpër ato shtigje të vështira mbajnë barrë tepër të rënda, jo vetëm ngarkesën me shkarpa ose me lëkurë, që i kanë për të shitur, por mbi të lidhet edhe foshnja në një djep të madh druri. Burrat ecin përpara me pushkë në krah dhe ruajnë tufën. Armët e zjarrit duhet t'i lënë pa hyrë në pazar. Është e vërtetë që një numër njerëzish kanë privilegjin që t'i mbajnë, por unë e kam vizituar

pazarin krejt vetëm kaq shumë herë, sa që nuk i besoj më ato rrëfimet që të ngrijnë gjakun për aq shumë mundësi vrasjesh, me të cilat ua mbushin mendjen udhëtarëve. Gjithashtu pasi e ke mësuar vetë rrugën, nuk mendoj se ka nevojë për ndonjë udhërrëfyes ose kafaz. Është punë e mërzitshme kur je me kafaz, nuk të afrohet njeri që të merret me ty. E kam bërë provë një herë, për një orë e ca, dhe nuk e kam bërë më. Por, ndonëse, nuk sheh vrasës, mund të shohësh raste kur duket se hakmarrja është kënaqur me ndonjë gjymtim, kështu mund të ndeshësh ndonjë burrë të cilit ia kanë prerë hundën para pak kohësh, aq sa blana e përgjakur e mbulon ende vendin e prerë. Ndërsa malësori ecën krenar drejt dyqanit, ku shiten fishekë, dhe i mbush vendet, që kanë mbetur të zbrazura nga koha kur ka qenë për herë të fundit në pazar.

Nuk kam vend këtu të përshkruaj veshjet e të gjitha fiseve, gratë me fundet e ngushta, të drejta e të trasha, të stolisura me rripa të zinj gajtani, që të kujtojnë veshjet e pikturuara në vazot greke të hershme, brezat e gjerë prej lëkure me thumba metali; gratë me guaskat në flokë; burrat e ashpër nga malësia me guna të mëdha prej lëkure deleje me leshin nga jashtë; gratë qytetare të krishtere, që ndritin nga veshja kuq e bardhë e me shumë monedha të praruara, kopsa argjendi dhe qëndisje; zonjat myslimane me një veshje të papërcaktuar, që mund të quhej «brekushe», ose me një term më të përpiktë «pantallona të pandara», të bëra me një beze të shkëlqyer gjithë lule, jo vetëm të mbuluara rëndë me çarçaf, po edhe me disa copa robe ngjyrë blu e ari të mbërthyera sipër kokës, që e mbështjellin gjithë gruan dhe i lejojnë vetëm një vrimë të vogël sa për të parë; gratë e varfra, të mbuluara me çarçaf të bardhë deri te gjunjët, që duken si fantazma në hyrjet e errëta; turqit me çallma, me dolloma të gjata dhe me shirita të ngjyrosura nga supet mbi gjoks; vajzat e vogla me flokët të ngjyer me të kuqe të fortë dhe me vetullat të nxira. Të gjithë njësohen në një grumbull të përzier verbues, në të cilin mund të dallosh diçka vetëm dalëngadalë dhe, kur unë u zhyta për herë të parë në këtë pamje të paharrueshme, kur pashë shkëlqimin e dritës së diellit, hijet e errëta e të plota, vezullimin e harlisur, papastërtinë, pompozitetin, plehrat, ngjyrat, lëkurët e saporrjepura, që shushurin në diell dhe të nxira nga mizat që i kishin mbuluar, një mijë e një mallrat e ndryshme për dy grosh e që vezullonin në duart e të gjithëve për t'i shitur, atëherë mendova, me dhimbje në zemër, për atë «gruan e shkretë» që po i kalonte orët e për-

hime, të mërzitshme, në një rrethinë të pangjyrë të Londrës, dhe, atëherë, e kuptova mallin e shpirtit të saj.

Nga të gjitha gjërat e botës së vjetër në këtë qytet, më të vjetra edhe se gurët e strallit të prerë mirë për urorin, që ende është në përdorim, më të vjetra edhe se kallcat e shtrënguara mesjetare, janë dollomatë e çlirëta, të lidhura me një shirit për beli dhe brekushet e gjera të lidhura te noçkat, siç i mbajnë burrat e djemtë e zakonshëm myslimanë të qytetit (një veshje mjaft e zakonshme në gjithë Lindjen). Kjo është veshja e burrave, që del në vazot greke të hershme, te dakët në kolonën e Trajanit, te galët robër në Luvër, është veshja e gjithë «barbarëve», e «braccati»* të romakëve. Romakët, togat e tyre dhe chlamys** — të gjitha ikën e vajtën, ndërsa këtu, në po ato vise të lashta, barbarët vazhdojnë t'i presin fustanellat e tirqet po me atë model të vjetër dhe vijojnë të jenë ende mjaft barbarë. Por ata kanë mësuar që t'i rruajnë kokat dhe të mbajnë një feste të bardhë. Me këtë ndryshim ne tani i njohim ata menjëherë si miku ynë i vjetër Pierrot***, historia e të cilit na tregon faktin që ai vërtet ka ardhur nga Lindja e Afërt, Venediku ka mbajtur nën zotërim gjithë bregun dalmat dhe një pjesë të Shqipërisë. Venediku ka qenë atdheu i maskave e i pantomimave dhe ndërmjet shtypshkrimeve të ruajtura për personazhet e pantomimave është një i quajtur «Zanne» me veshjen e njohur si «Pierrot». Për ta paraqitur si lolon e një pjese, a kishte më të përshtatshëm sesa një trashaman nga krahinat e pushtuara? Edhe sot e kësaj dite në të ashtuquajturat qytete të qytetëruara njerëzit e shtresave më të ulëta janë gati ta bëjnë lolo një të nuaj fatkeq. «Zanne» erdhi në Angli dhe është përfshirë në njërin nga skeçet për shfaqjet me maska të Ben Xhonsonit***.

Fundet për ne janë një veshje thjesht për gra, por fundi i barbarëve është zhvilluar në Shqipëri në një fustanellë të gjerrë e të madhe dhe beu mysliman vjen rrotull me të madh me një fustanellë të vështirë për ta mbajtur, që i arrin deri te noçkat dhe që i fryhet anash si fundet e modës së vjetër për balelinat. Ai nuk mund të punojë, sepse mban fustanellë dhe thuhet se ai e mban fustanellën që të mos jetë në gjendje të punojë.

* Lat. shallvare, brekushe.

** Lat. pelerinë e gjerë prej leshi e fisnikëve të Greqisë së lashtë.

*** Figurë komike e teatrit italian në Paris, që vishej me të bardha dhe e ngjyente fytyrën me të bardhë.

**** Dramaturg anglez (Ben Johnson, 1573-1637), bashkëkohës i Shekspirit, autor kryesisht i komedive për jetën e përditshme.

Për këtë veshje madhështore e qesharake shkojnë dyzet metra copë. Pjesa më e madhe e palave mbahet përpara dhe, ndërsa ai që e mban ecën, palat tunden me ngathtësi nga njëra anë në tjetrën. Grekët e kanë marrë atë në një formë të modifikuar, por duhet ta shohësh të veshur nga një shqiptar që të kuptosh mundësitë e saj. Deri tani, shqiptarët rrallë ia kanë dalë të bëjnë diçka në mënyrë të përmbajtur. Pasi i pata parë se çfarë mund të bënin burrat me një fund të tillë, nuk u habita më kur barrinjtë e fushave e pyesnin udhërrëfyesin tim me interes të veçantë nëse unë isha burrë apo grua.

Por na duhet ta lëmë pazarin, ndonëse nuk mund ta shuash kureshtjen për të as me shumë ditë, ta lëmë këtë vend piktorik, ku të ligështon afshi i gjakut, lagjen e kasapëve, një bashkëpajtim i ngjyrave rozë me allen, ku qentë lëpijnë gaviçat e kuq, kasapi fshin pas vitheve thikën e ngjyer, ndërsa njerëzit largohen me një llokmë dashi për të bërë drekën, ta lëmë Pazarin e Plaçkave të Shkodrës, ku krahas pircjeve me rrangullira nga më të ndryshmet, janë nxjerrë në treg stolitë e zonjave shqiptare dhe zbukurimet e tjera. Plaka të thyera në moshë e po aq të lashta sa edhe çikërrimat që shesin, rrijnë ulur përdhe. Rrezet e diellit ndrisin mbi qëndisimat e praruara, magjistaria që i ruan, ashtu si Atropos*, lëvdon bukurinë e tyre me një palë gërshërë të mëdha në dorë, kurse Lakesia** dredh një fill leshi. Do të betohesha se ato ishin vetë Fatitë*** që po shesin rrobat e viktimave të tyre.

Nga pasditja, turma e fshatarëve, tashmë, nis të ngarkojë kafshët e barrës, të mbuluara me hajmali për t'i mbrojtur nga syri i keq dhe me mëgojëza të zbukuruar me rruaza bojë qielli. I presin në të dalë të pazarit, ku farkëtarët evgjitë dhe bakër-xhinjtë, gjysmë të zhveshur e me trupin gjithë vija nga muskujt e fortë, punojnë në kasolle të vogla të bëra me thupra dhe me teneqe vajguri të hapura si fletë llamarine. Është e vështirë ta marrësh me mend sesi ia kanë bërë përpara se të hynte në këtë vend teneqja e vajgurit. Në duart e evgjitëve, kjo është lënda e parë nga e cila bëhet pothuaj çdo gjë tjetër.

Fshatarët ngarkojnë kafshët (janë shumë të aftë për ngarkimin e barrëve dhe rrallë mund të shohësh një kafshë me ku-

* Njëra nga tri Fatitë në mitologjinë greke.

** Lachesis, njëra nga Fatitë, e cila turrte fillin e jetës dhe përcaktonte gjatësinë e saj.

*** Sipas mitologjisë greke, tri gra magjistare e të pamëshirshme, që përcaktonin lindjen, jetën dhe vdekjen e çdo njeriu.

rriz të lënduar) dhe nisen zvarrë-zvarrë përmes fushave, drejt shtëpive të tyre në malësi. Pazari mbyllet, bie shpejt errësira dhe udhëtarët këmbësorë të vonuar e gjejnë rrugën me fenerë.

Nata në Shkodër është fsheharake. Ato nja gjysmë dyzine llampash me vajguri fare të vockla nuk e ndriçojnë aspak. Kur nuk ka hënë, errësira është e plotë dhe e padepërtueshme, me përjashtim të ndonjë rripi të gjatë drite, që del nga plasa e derës në dyqanin tjetër dhe të dritareve të ndriçuara në xhaminë përballë. Siluetat e errëta të figurave, që falen brenda tyre, ngrihen e ulen, por vetë xhaminë e ka gëlltitur errësira që e rrethon. Në rrugë duhet një xixëllimë, është dikush që kalon me fener dhe zhduket. Rruga mbetet e vdekur deri sa tringëllin një shpatë dhe kalon roja. Dritat në xhami shuhen. Errësira bëhet e dendur dhe e vdekur, nuk pipëtin asgjë. Ora është vetëm nëntë e darkës, por gjithë Shkodra duket se ka rënë në gjumë.

Vetë qyteti i Shkodrës, po ta veçojmë nga pazari, nuk ka shumë gjëra për të vizituar. Është një qytet i madh me rreth 40 000 banorë dhe të gjitha shtëpitë, pavarësisht se sa të mëdha janë, kanë një oborr ose kopsht të madh, që zë shumë sipërfaqe. Këtu çdo shtëpi është edhe një kështjellë, prandaj muret janë jo vetëm për ta mbyllur oborrin, por edhe për mbrojtje. Herë pas here, në Shkodër përhapen fjalë se mijëra veta po vijnë për ta sulmuar. Mbyllen të gjitha dyqanet, dyfishohen rojat tek urat dhe gjindja mbyllen nëpër shtëpi. Ushtria fantazmë nuk duket gjëkund dhe për dy-tri ditë gjithçka merr rrugë si më parë. «Por një ditë ajo do të na sulmojë», më tha një burrë, kur unë qesha me fjalët për një ushtri prej dyzet mijë vetash që kurrë nuk ishte dukur.

Lagjja myslimane duket më e pasur dhe e një shkalle më të lartë shoqërore. Shtëpitë, të cilave mund t'u hedhësh një sy nga portat, janë të mëdha e të rënda. Porse rrugët janë të shkreta e të trishtuara. Aty-këtu takon nja dy gra me ferexhe, të cilat po nuk u duk ndonjë burrë rreth e rrotull, zakonisht përpiqen shumë që të njihen me ty dhe për këtë edhe e zbulojnë fytyrën pjesërisht. Mirëpo, meqë unë nuk di as shqip e as turqisht, nuk ia kam arritur të bëj gjë, vetëm sa më kujtonin «frënge» dhe shkëmbejnë mjaft buzëqeshje dhe tundnim kokat. Veçanërisht dy prej tyre bënë një rrugë të gjatë me mua, duke çuquritur gjithë kohën dhe që të them të drejtën, ato ishin që të dyja vajza shumë të bukura. Në Shkodër mbajnë çarçaf jo vetëm gratë myslimane të qytetit por edhe katoliket, ndërsa gratë e fshatit nuk mbajnë. Deri sa të martohen, ato mbahen të mbyllura në

një mënyrë të atillë sa, sipas përfytyrimit tonë, vetëm një hap e dallon këtë nga burgimi. Ky fakt hedh një dritë të fortë për gjendjen e rëndë të asaj shoqërie që ua ka bërë të detyrueshme këtë gjë, meqë rregullat e mirësjelljes së shoqërisë zakonisht mbështeten në të vërteta të palëmuara e të pakëndshme. Do të ishte një marrëzi e kotë që t'u parashkruaje idetë perëndimore të shekullit të 20-të këtyre njerëzve të pazhvilluar, por mbetet si fakt që jeta e gruas shqiptare mesatare është shumë e rëndë. Jeta e gruas fshatare është një rreth i pafund angarie të rëndë, ndërsa ajo e gruas së varfër qytetare, siç më kanë thënë, shpesh kaion që nga mëngjesi deri në mbrëmje pranë vegjës, një punë që ndërpritet vetëm kur Fatia e Zezë ia pret fillin e saj.

Ndonëse myslimanët në qytet janë shumë më tepër se të krishterët, xhamitë janë të gjitha disa ndërtime të vogla e të rrafshëta, që i shpëton nga snëmtia vetëm hijeshia e minareve të tyre të gjata e të holla, madje nuk ka shumë xhami. Ushtria turke, së cilës i mungon në mënyrë qesharake ndjenja e përshtatshmërisë së gjërave, kur ka datën e larjes së teshave, e përdor varrezën më të madhe si vend për të tharë rrobat, këmbë që në çdo gur varri varen një këmishë ose një palë pantallona që valëviten nga era. Vetëm kur sodita këtë pamje, më shkoi ndër mend se edhe ushtarët turq paskan një ditë pasarmi. Një turmë shejtanësh të vegjël, të pistë, të varfër, thatiqë e të pakrehur, me fytyra të vrenjtura, duken më tepër sikur janë kthyer nga ndonjë fushatë shkatërrimtare sesa sikur janë në kazermat e kryeqendrës. Dhe mjafton pamja e tyre që kushdo të besojë me lehtësi thashethemet se ata jo rrallë i bëjnë hall vetes për të gjetur mish duke kapërcyer kufirin, ndërsa «hyqymeti», në atë kohë me mirëbesim, e ka kthyer kokën nga ana tjetër. Nuk është për t'u habitur me aftësinë e qëndresës së tyre në kohë lufte, po të merret parasysh jeta e tyre gjatë kohës së «paqes». Krahasimisht me këtë, një përleshje në të cilën mund të rrëmbesh gjithçka të zë dora, është një pushim i këndshëm.

Lagjja katolike e Shkodrës duket më pak e lulëzuar dhe ka kryqe mbi disa porta, por përveç kësaj, të dyja lagjet ngjasin mjaft midis tyre. Qytetarët katolikë mbajnë një veshje të veçantë. Kostumi i burrave është i çuditshëm, ndërsa veshja e grave është më e keqja që është prerë ndonjëherë. Benevrekët e tyre tepër të mëdha prej pëlhure alle e të zezë, që i mbështjellin deri te nockat, i pengojnë aq tepër sa gruaja shpesh është e detyruar që t'i ngrejë përpara me të dyja duart për të mundur të ecë. Ajo kthehet në një rrumbull në trajtë dardhe, të rëndë,

të fryrë e qesharak, me fytyrën të mbuluar nga carcafi dhe me pjesën e sipërme të trupit të mbuluar nga një xhamadan i kuq, të qëndisur me ar dhe me një copë katrore që i shërben si këdhë këmbësoret anash janë të larta. Gurë të mëdhenj kalldrëmi, si ata në Pompei, dalin në rrugë pa e penguar kalimin dhe, me sa duket, as karrocet nuk e kanë të vështirë t'i kapërcejnë.

Katedralja e katolikëve është një ndërtesë e madhe me tulla, e bërë nja pesëdhjetë vjet më parë. Ka një kambanare të gjatë dhe pjesa e poshtme është e rrethuar nga një mur i lartë. Hapësira e madhe e brendshme është e zhveshur, sepse nga mungesa e parave nuk ka vuajtur shumë prej «zbukurimeve». Te porta, gratë i heqin çarçafët dhe hyjnë në shtëpinë e zotit me fytyra të zbuluara, por fytyrat i kanë të bukura, me hundë të rrera pastër, pak të kthyera, me lëkurë të dëlirë si qelibar, me buzë të kuqe dhe me sy të zinj e qerpikë të gjatë. Në anijatën e kishës ka frona, por një pjesë e madhe e grigjës, vecanërisht malësorët, që grumbullohen në ditët e festave, parapëlqejnë të ulen në truall. Ata shtrojnë një qilim të vogël ose një shami, heqin opingat dhe shtrohen këmbëkryq si në ndonjë xhami, gratë i kanë gjokset të mbuluara me pare që shkëlqejnë, ndërkohë që ato lëkunden para e prapa, duke u lutur, ndërsa malësorët i kanë gjerdanët përsipër të gatshëm për t'i përdorur kundër një vëllai shqiptar. Është një shkëlqim i hijshëm i kohëve barbare i ngjyrave, i të kuqes alle, alle e përsëri alle. Fillon shërbesa. Zëra të ashpër e që nuk bashkëpajtojnë, të lartë e therës këndojnë refrenet, ndërsa zëri i thellë e tingëllues i një italiani të ri, tek altari, bubullin si zëri i qytetërimit mbi ulërimën barbare të grigjës. Ndërsa ai njoitet tek amvona e kuqe dhe e praruar, bie një qetësi pritëse. Mesha në gjuhën shqipe është e gjatë dhe turma dëgjon pa pipëtirë fjalët e tij. Veprimet dhe recitimi i tij janë të thieshta e me diniitet, unë e ndjek sesi e tërheq grigjën me interes të thellë, ndonëse unë nuk kuptoj asnjë fjalë. Ai po përpiqet që të ngjitet në kulm dhe e arrin papritur me një fjalë që mbaron me të vetmen fjalë jo shqipe të meshës: «Inferno»*. Fjala gjëmon teposhtë kishës me «rrr» që rrotullohet gjatë dhe ai qëndron krejt i heshtur, i kapur pas buzës së amvonës e duke hedhur vështrimin përsipër kokave të nierëzve. Bie një qetësi e dhimbshme që duket sikur zgjat me minuta. Pastaj, ai befas bie mbi giunjë tek amvona dhe nis faljen. E prekur thellë, grigja e tij kridhet në pasionin e lutjes dhe

* Ital. ferri.

ata, që janë ulur përdhe, përkulen më dysh e prekin dyshtemenë me ballë.

Grigja barbare gjithë lara, mësuesi i ri asketik e zellmadh, zërat e ngjirur gjamatarë, që bubullojnë nëpër kishën e madhe e të zhveshur, përbëjnë një tërësi krejt të pashpjegueshme që të lë një përshtypje të madhe të dhimbshme. Vështroja këtë turmë që falej dhe më kot përpiqesha ta gjeja me vete se çfarë ideje mund të kenë ata për krishterimin dhe me çfarë besime të botës së lashtë, para krishterimit, e përziejnë. Shqiptarët janë mbërthyer pas tyre në çdo gjë dhe fretërit, megjithëse kanë bërë çmos, fare pak ia kanë dalë ose nuk ia kanë dalë fare të arrijnë diçka kundër gjakmarrjes. Shqiptari kurrë nuk u është përshtatur gjërave, ai ia ka përshtatur vetes gjithçka. Ai e praktikon krishterimin, duke qenë krenar, me po atë furi që bën gjithçka tjetër. Ai mban kreshmë me rreptësi, mban një kryq si hajmali dhe kujdeset me të tepërt që shenjën e kryqit ta bëjë si katolikët dhe jo si ortodoksët. Por pikëpamjet e tij janë krejt materiale.

— A e keni shpirtin e shenjtë në vendin tuaj? — më kanë pyetur disa herë. Kur u jepja përgjigje pohuese, atëherë përgjigjeshin me entuziazëm: — Atëherë, Anglia qenka njësoj si Shqipëria! — Është me interes të lexosh jetën e Benvenuto Çelinit* pas një udhëtimi në Shqipëri, sepse ajo paraqet me besnikëri të madhe shkallën e zhvillimit fetar në të cilën ka arritur sot shqiptari.

Në Shkodër, ka shumë pak shqiptarë ortodoksë. Ata që janë, mbajnë po atë veshje si edhe myslimanët, por gratë nuk mbulohen me ferexhe.

Po të lësh mënjanë doket, Shkodra ka pak gjëra të lashta, përveç rrënojave të kështjellës së vjetër, që kurorëzojnë kodrën mbi qytet. Thuhet se muret janë të kohës së Venedikut** dhe kanë qenë fare mirë të ruajtura deri tridhjetë vjet më parë, kur pashai i vendit, meqë kishte dëgjuar për rrufepritësit, vendosi ta blinte një dhe ta vinte për ta mbrojtur më mirë kullën, që përdorej si depo baruti. Për këtë qëllim ai zgjodhi një shtizë të mirë tunxhi, mirëpo pastaj e pa se duhej të paguante sipër saj edhe një sasi të madhe teli. Meqë ishte i kursyer, mori vetëm shtizën, e vuri në majë të kullës dhe priti me padurim ndonjë shtrëngatë. Edhe ajo erdhi shpejt! Shtiza e bukur prej

* Gdhendës, skulptor dhe argjendar nga Firencja (1500-1571).

** Kështjella e Rozafës është e lashtë, gjurmët më të hershme mund të jenë të shek. IV para erës së re, venedikasit e morën vetëm më 1396.

tunxhi e thithi menjëherë rrufenë. Shpërtheu depoja e barutit dhe, përpara syve të tij të habitur, pjesa më e madhe e kalasë u shkallmua. Kodra tani kurorëzohet nga një kopicë rrënojash, por meqë të huajve u ndalohet rreptësisht që ta vizitojnë, unë mendoj se turqit do të kenë ndërtuar ndonjë gjë midis tyre, që e quajnë kala.

Në rrëzë të kësaj kodre, janë rrënojat e një kishe të vogël. Mbi të janë bërë disa kryqe të mëdha e të bardha dhe vendi mbahet për fort i shenjtë. Çdo fshatar i krishterë ndalon, kur kalon aty pari, bën kryqin, dhe ndonëse kanë mbetur vetëm disa fragmente muresh, më kanë thënë se ende bëhet ndonjë shërbesë rastësisht. Relikja tjetër e vetme nga kohët e shkuara, aty rrotull, është ura e hijshme prej guri me harqe pranë Mesit*, nja shtatë kilometra larg Shkodrës përtej fushës. Kjo është, pa dyshim, një punë e kohës së venedikasve. Ura kalon mbi një përrua që vërshon në stinën e shirave dhe i ka sjellë shumë dëme qytetit e ka prishur një pjesë të madhe të fushës. Pjesa tjetër e fushës është e mbuluar me driza të ulëta e me shkurre fieri, dhe e kullosin tufat e dhenve e të dhive. Të gjitha së bashku përbëjnë një pamje të cuditshme e të egër: barinj të veshur me lëkurët leshatake e të armatosur me pushkë, varganet e fshatarëve e të kafshëve të barrës që hiqen ngadalë, duke shkuar në pazar ose duke u kthyer dhe vargu i kaltër i maleve rripa-rripa. Në rast se do të merrni një shqiptar me vete oë t'ju mbajë me muhabet, meqë kushdo «kërkon të dijë», më duket se nuk ka asnjë rrezik të endesh nëpër këto anë.

Shkodra është kryeqendra, por nuk ka asnjë rrugë për të qenë deri në liman. Ky është në të dalë të liqenit, por nuk është bërë asgjë, ndonëse pak punë e ca para do ta bënin lumin Buna të lundrueshëm për avullore të vogla dhe të gjitha brigjet e liqenit do të lidheshin drejtpërdrejt me detin. Përdoret fare pak kjo rrugë, që do të ishte lidhia kryesore tregtare për Shqipërinë e Veriut dhe për një pjesë të madhe të Malit të Zi. Eksportet nga Shkodra nuk janë aq të mëdha sa ta shqetësonin vetë Shkodrën. Shumicën e eksportit, nga rrethinat fqinie e përbëjnë lëkurët, duhani, ca rrënjë shqemeje dhe lëvore për të ngjyer e për të regjur, pak misër e fruta dhe një sasi breshkash që shqiptarët i gjejnë të gatshme. Shkodra është një nga qendrat e pakta ku gjërat mund t'i lësh me sigurinë e plotë se vitin e ardhshëm do t'i gjesh ashtu siç i ke lënë.

* Është ndërtuar në gjysmën e dytë të shek. XVIII dhe nuk ka të bëjë me venedikasit.

KREU III

NGA SHKODRA NË ULQIN

Sidoqoftë, për një pikë unë kam të njëjtën ndjenjë të përbashkët me shqiptarin. Shkodra më mrekullon. Kur nuk jam atje, po jua rikujtoj që vetëm atëhere, jam pothuaj gati të be-tohem bashkë me shqiptarin se ajo është qyteti më i mirë në botë dhe kështu, një vit pas vizitës së parë, e pashë veten përsëri në një avullore që shkonte drejt Shkodrës, duke pasur si qëllim që prej andej të kaloja në Ulqin. Shkodra më përshëndeti ngrohtësisht si një mik të vjetër. Ai nëpunësi i ekzaltuar persian më priti hareshëm dhe më tha se për zonjushën nuk kishte nevojë për pasaportë, në doganë më lanë të kaloja pa pengesë dhe, shpejt, u vendosa rehat në dhomën që kisha pasur. Persiani, për shkak të miqësisë sonë të vjetër, siç më tha, por në të vërtetë, sepse po vdiste nga kureshtja, më bëri menjëherë një vizitë me atë xhaketën e bardhë të palarë e të rrudhosur, me të cilën e mbante veten më të madh dhe më bëri muhabet me mirësjellje.

Megjithëse kënaqësitë e Shkodrës ishin të mëdha, kisha si pikësynim Ulqinin, mirëpo nuk po shihja mundësinë sesi t'i afrohesha. Të gjithë sikur ishin marrë vesh që të më trembnin për të mos e marrë atë rrugë. Pasi kalova në Shkodër gati një javë, megjithatë e binda veten se shqiptari është një njeri mikpritës, por pa ndonjë prirje tjetër për të mirë, dhe prandaj e mora përsipër gjithë përgjegjësinë që ta vija në zbatim planin tim. E vendosa të veproja me një vrull. Si udhërrëfyes, mora Dacin, i cili erdhi herët në mëngjes me një mëz të fuqishëm, u dhashë lamtumirën dhe u nisa përmes qytetit më këmbë. Daci më tha i vrenjtur se ishte e kotë t'i hipja kalit, para se të kapërcenim vendin, ku duheshin treguar pasaportat, sepse turqit ishin shumë të këqinj për pasaportat, dreqi vetë ishin në fakt. Këtë më tha me një pamje nënshtrimi sikur edhe po të ishte krejt e

mundur, nuk do ta vlente të hipje në kalë fare. Ecëm gjatë brigjeve të Bunës deri sa arritëm te pika, ku bashkohet Drifantastik drurësh mbi të dhe në urë qëndronin ushtarët me ato rrecka të ndotura, që turqit i quajnë uniforma. «Pasaportën tuaj» më tha Daci me ngut. Unë e nxora, mirëpo meqë asnjë nga autoritetet nuk dinte të lexonte gjë tjetër veç turqishtes, ishte punë e kotë. Daci dukej i shqetësuar. «Duan emrin tuaj» më tha ai, duke parë kapakun e pasaportës, ku ishte e shtypur: «Mary E. Durham», pastaj lexoi me pamje fitimtari: «Marie». Të gjithë u kënaqën. Kisha hyrë në Shkodër si «Editi e Londrës», tani po e lija as më shumë e as më pak, por si «Maria e Anglisë». Të mirat e sistemit të pasaportave janë vërtet të mëdha e të dukshme. U dhashë dy grosh bakshish dhe e kaluam urën. Daci ishte një njeri që e ndërronte shpejt gjendjen shpirtërore, u gjallërua sapo i lamë prapa turqit. Ai më tha se i pëlqenin anglezët dhe se tani mund të hipja në kalë.

Pasi ecëm me kënaqësi nja një orë, rruga nisi të bëhej e keqe e pastaj edhe më e keqe, e mbushur tejprtej me ujë. Buna kishte vërshuar dhe ujërat ishin derdhur.

Ndërkohë, po na arrinin retë e shtrëngatës. Për fat kishim mbërritur në një rrugë më të mirë dhe gjetëm strehë nën një pemë të madhe. I gjithë peizazhi u zhduk prapa një përroi të përhimë dhe befas, prej tij doli një nga figurat më të egra që kam parë ne jetën time, një grua plakë, shumë plakë, e gjatë dhe e thatë, e veshur vetëm me një palë tirqe pambuku, të lidhur nën sqetulla. Flokët e saj të qullur, zbrisnin nga koka si gjarpërinj të zinj e të gjatë dhe ajo qëndronte në mes të shiut e tundte krahët fort si krahët e mullirit me erë, duke folur shpejt shqip. «Ajo kërkon që të vemi në shtëpinë e saj», më tha Daci. «E ka këtu afër», ashtu siç e tregonte ajo përmes shiut, «nja gjysmë ore larg». «Jo, faleminderit», — i thashë. E përsëri plaka tundi krahët e na bërtiti. «Faleminderes» përsëriti Daci disa herë me një zë të thellë e të njëtrajtshëm. Plaka bëri edhe një përpjeke të fundit «Në emër të zotit ajo na lutet një milion herë që të vemi», tha Daci me buzëqeshje. «Na thotë se nuk ka çfarë të bëjë tjetër për ne». Ishte e qartë se nuk kishte çfarë të bënte dhe u zhduk përsëri, përmes shiut, po aq befas sa ishte dukur.

— Më mirë të rrimë këtu në të thatë, — tha Daci.

— Sa larg jemi nga Ulqini? — e pyeta unë.

— Të paktën dy orë, — tha Daci.

Unë po mendohesha e mërzitur nëse hejbet e plaçkave e

mbanin ujin apo jo dhe për të vetmet tesha që kisha si ndërresa.

Kur shtrëngata pushoi, u nisëm përsëri, kështu, me shi e me diell, arritëm përmes një rrebeshi të rëndë deri atje, ku e shihnim Ulqinin, ndërsa veshi më kapi atë tingullin më melankolik, që del kur tringëllin një patkua i çliruar. I thashë Dacit të na gjente hanin më të mirë. Ai më tha buzëvarur:

— Ka vetëm një han, — dhe ne iu ngjitëm një kodre dhe hymë në qytet, që ishte një radhë shtëpish, një farkë, një xhami e disa dyqane. Për tmerrin tim hymë në një pijetore shqiptare fare të vockël.

— Ecco l'albergo*, — tha Daci. Unë kërceva nga kali dhe vrapova brenda për të shpëtuar nga rrebeshi. Unë kulloja nga koka te këmbët, Daci po kullonte dhe kalit i kishte rënë patkoi, ndërsa kishim bërë afër nëntë orë rrugë në vend të pesë orë e gjysmë. Prandaj, do të pranohem çdo liman në këtë furtunë. I zoti, i veshur me pantallona me vija, na dha mirëseardhjen me plot fjalë në një italishte të çalë. Më kaloi përmes një kuzhine me dysheme prej dheu dhe më ngjiti në disa shkallë druri deri te një «molto bella camera»* sipër dyqanit, duke folur me gjallëri. Ishte një dhomë e vockël, pa orendi, me përjashtim të një gruaje me brekushe që ishte krusbulllosur në gjumë të rëndë mbi një grumbull dyshekësh, përsipër një lloj minderi me arka ambalazhi. «Gruaja ime», më tha ai duke i dhënë një të shtyrë, ndërsa ajo kërceu si kukullat e lodrave prej druri. më hodhi duart në qafë dhe më puthi tri herë. Erdhi Daci me hejbet. Ai hodhi një vështrim vlerësues rreth dhomës. sepse ky ishte lloji i vendeve, ku ai e ndiente veten si në shtëpi të vet, dhe më tha se ishte «dosta dobra» (mjaft e mirë) dhe se këta njerëz ishin të gjithë të krishterë dhe shumë të mirë. Pastaj, më këshilloi me ngulm se ishte mirë të ndërrohesha e prandaj më mirë do të më linte vetëm dhe ata dolën. «Ndërresat» e mia ishin mbledhur me një mushama dhe futur në hejbe, kështu që ishin krejt të thata. Pasi m'u çlirua mendja nga kjo gjë, nisa t'i peshoja mundësitë për t'u rregulluar këtu. Njëra nga dritaret kishte pasur dikur një xham, kurse tjetra nuk kishte pasur fare. Përvec kopicës me shtroje, në dhomë nuk kishte gjë tjetër, po vetëm një pushkë, një gierdan dhe një pikturë të Shën Gjergjit. Shiu po binte me litarë, po të kërkoja dhomë tjetër do t'i bëia oull edhe të vetmet rroba të thata që më mbeteshin, për më tepër,

* It. ja bujtina.

** It. dhomë shumë e mirë.

isha e lodhur. Vendosa të qëndroja për t'u strehuar në për në dhe zbrita në «kuzhinë».

Dyshemeja ishte prej balte dhe e pjerrët, sepse shtëpia ishte ndërtuar në një faqe kodre. Në një qoshe Daci, i zoti i bisht rreth një zjarri bubulak i cili flakëronte mbi një shkëmb guri. Zonja po bënte kafën, kurse zotnia një limonatë. Menjëherë më bënë një vend dhe unë u bashkova me rrethin që rrinte në bisht. Ata ishin shumë të shqetësuar për shëndetin tim, më prekën për të parë a ishin vërtet të thata rrobat dhe zonja, meqë nuk më bënte dot që ta kuptoja me fjalë, më puthi duart e fytyrën. Zotnia më tha se zjarrin e ndezëm enkas për mua dhe tani do të kënaqeshim të gjithë. I fola Dacit me gjysmë zëri se mos gjendej ndonjë vend më i mirë, por ai ishte i sigurt se nuk kishte asnjë han tjetër. Ndoshta mund të gjendej një dhomë në ndonjë shtëpi private pranë detit, por duhej shkuar nja gjysmë ore larg, për më tepër, këta ishin njerëz shumë të mirë dhe i kishin dhënë atij hua një pallto e një palë patkonj. Mikpritja e tyre e përzemërt më ngjalli besim që në fillim, më tërhiqte edhe primitivizmi i madh i vendit. I thashë vetes: «Deshe të shohësh shqiptarë dhe ja ku të ka çuar zoti në duart e tyre. Ky është një rast i papërsëritshëm». U vendosa dhe u përpoqa të sillesha sikur isha e familjes. Daci më dha lamtumirën me mirësi dhe m'u lut t'i bëja të fala iksit në Forin Ofis, atij zotërisë më trim, më fisnik dhe më të dashur në gjithë botën, dhe t'i thosha se ai (Daci) do t'i falej zotit ditë e natë për ta mbrojtur e që të kthehej përsëri në Shqipëri. Pastaj të tjerët, të cilëve u qe ngjallur kërshëria, morën vesh për veprimet e lavdishme të iksit dhe fakti se unë isha bashkatdhetare e tij peshoi shumë në të mirën time. Në këto qoshe të mënjanuara nami i Perandorisë varet tërësisht nga sjellja e dy ose tre vetave që u ndodh të jenë përfaqësues të saj dhe, me të vërtetë, mbi ta bie një përgjegjësi e rëndë.

Daci u nis dhe unë e ndjeva veten pak të vetmuar, por të tjerët u gëzuan me mua siç bëjnë fëmijët me një këlysh maceje.

Herë pas here, zotnia dilte në dyqan për t'u dhënë raki klientëve dhe lajmi për arritjen time u përhap shpejt. Kur klientët ishin të radhës së ulët, i ftonin të më shikonin, kur përkundrazi, ishin njerëz të mëdhenj, për shembull kapedanë malazez, zotnia më lutei nëse do të kisha mirësinë të dilja e t'u flisja. Ata ishin të gjithë burra shtatlartë, të sjellshëm e miqësorë, por asnjëri nuk fliste gjuhë tjetër veç serbishtes. Shiu vijonte të rridhte, por meqë kushdo, që hynte e vinte të më

shihte mua, merrte një gotë, tregtia po ecte. Një zotni, që fliste italisht, ishte një spitullaq aq i madh, sa që unë e pyeta nëse kishte ndonjë hotel më të mirë në këtë vend. Kjo e habiti atë dhe m'u përgjigj se nuk kishte, për më tepër gatimi këtu ishte shumë i mirë.

Meqë shiu kishte pushuar dhe jashtë ishte ende dritë, i zoti i hanit më propozoi që të dilnim për një shëtitje. Qyteti ishte jo i vogël, dyqanet janë bërë prej druri, shumë prej tyre në stilin turk. Hymë në miaft syresh jo për të blerë gjë, por që një-rëzit të më shihnin mirë dhe unë u shtrëngoja dorën të gjithëve, ndërsa zotëria fryhej gjithë krenari.

Të nesërmen, dola që t'i hidhja një sy Ulqinit në dritën e ditës.

Gjiri është shumë i bukur me qytetin e vjetër në kep dhe me muret venedikase. Qyteti shtrihet teposhtë luginës dhe rrotull gjirit, disa minare xhamish flasin për turait. Në qytetin e vjetër, pjesë të gdhendura të futura në muret dhe gurë të latuar mirë janë gjithcka ka mbetur nga pushtimi venedikas. Ulqini ra në duart e osmanëve, më 1571 dhe u mbeti atyre, ndonëse Venediku bëri dy përpjekje për ta rifituar. Më 1877, e mori Mali i Zi, por iu kthye turqve nga Kongresi i Berlinit dhe, më së fundi, iu dorëzua Malit të Zi nga Fuqitë më 1880. Ulqini ka një gjë të mirë, por meqë ende nuk është i lidhur me brendësinë e vendit me ndonjë rrugë për të qenë, nuk bëhet ndonjë gjë e madhe për qarkullimin.

Kur u ktheva, gjeta një kalë të bardhë dhe tre veta që po më prisnin. Njëri ishte udhërrëfyesi dhe dy të tjerët ishin «dy sinjorët» për të cilët më patën thënë se kishin për të bërë po atë rrugë.

Hyra në han dhe pyeta për pagesën. Zotërisë i vinte zor. Më pa nga këmbët te koka dhe më peshoi se sa e nasur isha. Pastaj më pyeti nëse tre franga ishin shumë. U kënaq, kur unë i pagova pa bërë zë, dhe më falenderoi disa herë. U ndamë me përzemërsi. Zonja më përqafoi tri herë dhe, meqë punët kishin vajtur kaq larg, unë bëra një përpjekje të fundit për të qenë shqiptare dhe e putha tri herë, shtrëngova duart me një varg burrash me tirqet vija-vija, i lidha teshat në shalë dhe i hipa kalit,

KREU IV

KOLASHIN-ANDROJEVIC-BERAN-PEJË

Ne priremi që të flasim për serbët e Serbisë si për «Serbët» dhe harrojmë se Serbia e sotme është një shtet i ri, i ngritur në mënyrë arbitrare nga Fuqitë dhe se përfaqësuesit e vërtetë të Perandorisë së Madhe Serbe janë malazeztë, të cilët gjatë pesë shekujve kanë luftuar kundër «armikut të besimit e të lirisë» dhe kanë jetuar për një ideal, për shpëtimin e kombit. Thuhet se çdo komb mban mbi kokë atë qeveri që meriton. Po të jetë kjo e vërtetë, Mali i Zi e ka merituar me të tepërt.

Ne e kishim parë malaziasin në qytetet e tij, le ta ndjekim tani në malësi.

Në Kolashin (shqiptohet me «a» të gjatë) mund të arrish për një ditë, duke udhëtuar gjashtëmbëdhjetë orë nga Podgorica. Më mirë ta bësh rrugën për dy ditë, që është më e lehtë dhe kënaqesh me udhëtimin. Në orën pesë, të një mëngjesi të qershorit, unë dola nga Podgorica me një farë Boshko, një djalë mjaft zeshkan, dhe me një kalë ngjyrë gështenjë.

Kolashini është një vend primitiv, por a do të qytetërohet ndonjëherë, kjo varet prej tij vetë. Tridhjetë vjet më parë, kjo qoshe e humbur ka qenë nën sundimin turk dhe e pazhvilluar. siç është Shqipëria sot, sepse gjithë energjitë e banorëve ishin përqendruar për t'u shkëputur toka turqve. Tri herë e pushtuan Kolashinin dhe tri herë u detyruan ta linin, duke u tërhequr para forcave më të mëdha. Këmbëngulja e egër e banorëve të krahinës së Kolashinit ia doli mbanë dhe që nga viti 1877 Kolashini u bë qyteti i katërt nga rëndësia për Malin e Zi. Buri- met e tij materiale nuk shfrytëzohen dhe nuk janë të shfrytëzueshme, sepse është i shkëputur nga bota meqë nuk ka rrugë dhe katër muaj në vit e zë dëbora, por në të ardhmen pyjet e mrekuallueshme dhe kullotat e mira do të sjellin para.

Shoqëruesit e mi e quanin Kolashinin si një qendër të ma-

dhe tregtie e qytetërimi, sepse kishin ardhur nga vende shumë më të egra. E zonja e hanit kishte lindur në Guci, një nga kësh-tjellat e njërit prej fiseve shqiptare më të ashpra. Ajo më tha: «Është qytet shumë i bukur, më i madh edhe se Kolashini, por ju nuk mund të shkoni atje se do t'ju vrasin».

Kolashini u tregua mikpritës dhe më lutën të qëndroja sa të kisha dëshirë. Boshkoja u dend me mish qengji dhe e ndiente veten për mrekulli, prandaj nuk ngutej të iknim. Por, një ditë retë u shpërndanë, majat e maleve dolën të pastra dhe unë u thashë të bëheshin gati për rrugë.

Andrijevisa ishte një qendër banimi fare e vockël (rreth 650 metra mbi nivelin e detit), e ndërtuar në një luginë buzë lumit, i cili derdhet teposhtë nga krahina e Plavës dhe e Gucisë e këtu bashkohet me një degë të vogël. Unë u ngjita te dyqani i furrtarit, një shtëpi e vogël e lezetshme e ndërtuar mbi një sukë.

Jeta në Andrijevicë është pak e rëndë, sepse ose është e qetë deri në mërzi, ose është mbushur plot me fakte shumë të ashpra. Shqiptarët, që janë përtej kufirit, përbëjnë një rrezik gjithmonë të pranishëm. Fuqitë e Evropës, të përfaqësuara nga shumë zotërinj të vlefshëm na u mblodhën në Berlin më 1878 dhe, së bashku, iu sulën Perandorisë Turke, e lëruan thellë dhe e ndanë në shtete. Tashti nuk është e lehtë të mbjellësh aty kombësi për të cilat dinë fare pak dhe në një vend, për të cilin ndoshta dinë edhe më pak. As mund të themi që vëmendjen e Këshillit na e paska tërhequr mirëqënia e këtyre të ashtuquajturave kombësi. Prandaj, nuk është edhe aq për t'u çuditur që kombësitë të cilave iu prekën drejtpërdrejt interesat, nuk u kënaqën dhe aq me rezultatet e arritura. Vëllezërit më të afërt të Malit të Zi janë në Serbinë e Vjetër, por bashkimi i popujve serbë nuk u përshtatej synimeve të Austrisë. Mali i Zi vuri ulërimën për bukë e për vëllezërit e tij, dhe iu dhanë në pjesën më të madhe gurë dhe shqiptarë. Brenda kufijve të Malit të Zi u përfshinë Plava e Gucia dhe menjëherë nisën turbullirat. Rregulli u vendos vetëm, duke e zëvendësuar këtë të quajtur çerdhe grabitqarësh me Ulqinin. Plava dhe Gucia iu lanë shqiptarëve, por kufiri i ndryshuar nuk u përcaktua për një farë kohe, kështu që u bë burim përleshjesh dhe sot e kësaj dite nuk respektohet me rreptësi. Siç ka vënë dikush në dukje në mënyrë të figurshme, ky kufi «noton», por kryesisht mbi gjak.

Në Beran vajta për të parë Gjurgjovi Stupovi, kishën e manastirit të Shën Gjergjit, sepse në Turqi ju gjithmonë duhet të keni një arsye të përshtatshme dhe të padëmshme për të udhë-

tuar, ndërsa prisja e mërzitur të pushonte shiu. Ishte si ditën e kiametit dhe dyzet ditët e tij do ta kishin zgjidhur Çështjen e Lindjes për sa i përket turkut.

Ne u kthyem në Andrijevicë me një rrugë tjetër, duke mos kaluar nga Berani dhe duke iu shmangur rojës në të hyrë, gjë që m'u duk një përkujdesje fare e panevojshme, por kjo u pëlqeu shumë shoqëruesve të mi.

Ngjarjet u rrokullisën shpejt. Të dielën ishte dita e Kosovës, kurse të hënën ishte ditë pazari. Nga Gucia zbriti një turmë e çuditshme, ishin malësorë të ashpër shqiptarë, me kokat të mbuluara me rrobë të bardhë dhe me sy hetues e të ndezur. Por, kohët e fundit ishte ndaluar që të sillnin armë në pazar dhe ata nuk mbanin mbi vete ndonjë gjë vdekjeprurëse, përveç gjerdanëve të mbushur mirë, të cilët i kishin madje edhe djemtë e vegjël. Unë interesohesha për ta dhe ata për mua, kështu që pjesën më të madhe të mëngjesit e kalova në treg dhe teposhtë buzë lumit, ku ata shisnin e prisnin dhen e dhi, kështu që gaviçat e kuq i shkonin aq për shtat pamjes, sa nuk të ngjallnin më nakati. Duke qenë e ndaluar për mua, Gucia më tërhiqte jashtëzakonisht dhe u mrekullova që gjeta një burrë nga Gucia, i cili do ta kalonte natën në bujtinën time. E kishte mbiemrin Gjoka, ishte me rrobat gjithë rripa gajtani si ndonjë tigër, fytyrën e rrahur nga dielli e kishte të pjekur e të rreshkur me rru-dha, sytë gështenjë të errët i ndrisnin sikur nxirrnin xixa. Kur do të plotësonte «fletën e klientit» e pyetën: «A je i krishterë apo mysliman?» Ai ngriti sytë me përtesë nga stoli, ku ishte shtrirë dhe e gjithë përgjigjja, që denjoi të jepte, ishte: «O zot, e ku ta di unë». Ndenjëm bashkë të dy pjesën më të madhe të pasditës. Kurrë më parë ai nuk kishte parë sesi bëhet një vizatim dhe prandaj kishte interes të madh. Kërkoj që ta vizatoja në atë mënyrë, që njerëzit të shihnin gjerdanin e ri të fishekëve dhe mbajti një pozë që ta tregonte sa më tepër që ishte e mundur. Pastaj më tha: «Po duhet të kem edhe një pushkë». Malazeztë e hodhën poshtë prerazi idenë që t'i jepnin burrit nga Gucia hua një pushkë qoftë edhe për qëllime të arteve figurative, prandaj na u desh të bënim pa të. Ai qëndroi i palëvizur dhe pa përpjekur as qepallat për njëzet minuta, pastaj për fat të keq ata, që sodisnin përreth, i thanë se puna kishte mbaruar. Ai kërceu përpjetë dhe erdhën aq shumë veta për ta parë vizatimin, sa që ishte e pamundur ta ulja përsëri.

Një profesor i botanikës dhe unë u këshilluam me të për mundësinë që të shkonim në Guci. Ai ishte gjithë hare, sepse portreti i vet i kishte pëlqyer shumë.

— Ne duam vetëm të shohim, — tha profesori i botanikës, — unë mbledh lule dhe i thaj, kurse kjo zonja do t'ju bëjë vizitime. Nuk do të merremi me politikë.

— Ti je burrë e s'ka për të besuar njeri, — i tha Gjoka i vendosur. — Kurse sa për zonjën, më mirë të mos shkojë. Ndoshta ka ndonjë rrezik, ndoshta edhe s'ka. Në Guci nuk është vendosur ligji. Vitin tjetër hajde ti, edhe ti.

— Po pse do të jetë e mundur vitin tjetër dhe tani jo? — e pyeta unë, por Gjoka hodhi një vështrim përpara me një shprehje të patrazuar të fytyrës dhe përsëriti ato që kishte thënë. Dhe lamtumira e fundit për mua ishte si fjalët e orakullit: «Vitin tjetër, o zonjë».

Të nesërmen në mëngjes, në orën nëntë, ishte një shërbesë solemne në kishën e vogël. «Krerët» me kostumet e mira erdhën, duke ecur në krye rëndë-rëndë, ndërsa pjesa tjetër e fshatit zvarritej pas tyre. Unë nuk mund t'i merrja vesh tërësisht lutjet, por emri i Prizrenit dëgjohej shumë herë, ndërsa kisha ishte e mbushur me luftëtarë të rënë në gjunjë, që luteshin me një forcë të dhimbshur për të rifituar Stara Serbija. Ylli udhërrëfyes për serbin, pikësnyimi i dëshirave të tij, ideali për të cilin ai rron dhe është gati të vdesë, është Serbia e vjetër dhe bashkimi i popujve serbë. Ne dolëm jashtë, në diell, hijerëndë e shumë të heshtur dhe në shumë fytyra dukej qartë një tendosje emocionale. Vojvoda më njohu me një oficer, që kishte ardhur atë mëngjes, dhe ia shpjegoi shkurt udhëtimin tim.

— Ne dëshirojmë që ju të vizitoni Serbinë e vjetër, — më tha Vojvoda. Unë isha renditur në një rresht me «krerët» dhe ecëm për t'u kthyer në fshat. Gjatë gjithë rrugës ata flisnin për Stara Srbija dhe vetëm për Stara Srbija.

— Ajo ka qenë zemra e perandorisë sonë dhe ju duhet ta shihni, — më tha oficeri. Kjo ishte një ide e re për mua dhe fluturonte madje përtej planeve të mia më të krisura. Ajo qoshe fatkeqe e Perandorisë Turke na qenkesh lënë pas luftës së fundit që të shkretohej nga shqiptarët. Asnjëra nga Fuqitë nuk dinte gjë e as nuk kishte çarë kokën se çfarë po ndodhte në atë qoshe të errët dhe udhëtarëve u ndalohej të shkonin, derisa nuk ngulën këmbë rusët që me forcë të vendosej një konsull në Mitrovicë. Harta ime ndërpritej në kufirin malazias dhe përtej tij fleta ishte e bardhë. Unë e peshova mirë çështjen rru-gës deri sa arritëm në fshat.

Sheshi i tregut ishte rregulluar si një natë më parë. Ne zumë vendet dhe u përsëritën argëtimet e natës së kaluar, vetëm se pa zjarre e të shtëna, sepse Vojvoda kishte thënë që po

të shkreheshin edhe më pushkë, shqiptarët do të mendonin se po bëhej ndonjë luftim dhe do të grumbullonin forca në kufi. Partë këndonin «Onamo, onamo», pra «Përpara, përpara, Prizrecilit, kënduam himnin kombëtar dhe pastaj mbrëmja u shpërdës dhe më morën me vete mua e profesorin e botanikës. Dhofeste, mbuluar me ar e me medalje. Hëngrëm mish dashi të ngrohtë dhe copat e vogla të mishit i merrnim në dorë, pimë raki. Vojvoda ngriti shëndetin tim, tha se unë isha si një dallëndyshe që shtegtonte për në jug e prandaj ashtu siç bëjnë dallëndyshet, duhet të kthehesha përsëri vitin tjetër. Ata të gjithë pinë për shëndetin tim, por jo për Anglinë, ndonëse vura dhe për Boheminë, që ishte atdheu i tij. Pastaj e kthyen përsëri vëmendjen nga unë për të më nxitur që të vizitoja Stara Srbija. I mora mendimin botanistit. «Shko, — më tha ai, — i vetmi rrezik janë shqiptarët, por ata kurrë nuk i prekin gratë». Unë u hodha një vështrim «krerëve» dhe pata besim. Vojvoda më tha se do të më jepte një letër që të më përcillte dhe kapiteni tha se do të më gjente një njeri e një kalë.

«Zemra e perandorisë sonë dhe froni i mbretërve tanë» nisi të ushtronte mbi mua një forcë tërheqëse të papërmbajtshme. Unë u thashë se do të nisesha që atë pasdite dhe ashtu bëra. Do të shkoja në Beran, që atje në Pejë e pastaj në Deçan, nga Deçani në Prizren dhe do të kthehesha në Andrijevicë, duke i rënë vendit përmes, ose më mirë do të përpiqesha që ta bëja këtë rrugë, pasi e gjithë ekspedita ishte e papërcaktuar, ndonëse e këndshme, meqë gjithçka varej nga «rrethanat», sepse atje ishin kudo turqit e pra nuk i kontrollonte dot kush rrethanat. Të gjithë u mbushën me entuziazëm dhe më thoshin se mbi të gjitha duhej të shkoja në Deçan, vendi më i shenjtë në gjithë Stara Srbija.

Ne arritëm në Beran dhe, meqë këtë radhë nuk ishte ndonjë ditë pazari për ta përlijtur ardhjen tonë, na kërkuan lejet e kalimit dhe na thanë të prisnim në han. Njerëzit në han u ekzistuan shumë, kur dëgjuan se çfarë rruge kisha ndërmend të bëja dhe më parashikuan një dështim. Prej shumë vjetësh, asnjë i huaj nuk kishte kaluar dot andej. Po prisja me shqetësim thirrjen për t'u paraqitur te kajmekami. «Ja ku po vjen!» më bërtitën dhe, befas, më thirrën që të takohesha për të më

pyetur, në mes të rrugës kryesore. Ishte një burrë i gjatë, i thatë, i vrenjtur, i cili më tha prerazi serbisht «Çfarë kërkoni ju?» dhe e ndjeu veten ngushtë, kur mori vesh kombësinë time dhe rrugën që kisha për të bërë. Kishte dyshime, kishte shumë dyshime. E frymëzuar nga përvoja që kisha me padijen e turqve, unë vendosa t'i bëja një bllof të guximshëm, por jo me bakhshish, dhe për habinë time e fitova lejen që ma dha gjithë hundë e buzë. Pasi arrita sukses, duke luajtur me perandorinë, i dhashë letrën e Vojvodës, «Vojvoda Lakiçi, — më tha, — hem, vojvoda Lakiçi, Vojvoda Lakiçi». E grisi dhe e hapi letrën, e lexoi, u ngërdhesh dhe më tha se mjaft ishte marrë me mua për të, u kthye mbrapsht me pasaportën time dhe me letrën, duke ecur e duke mërmëritur: «Vojvoda Lakiçi». Hani dhe klientët e tij ishin të gëzuar. «Do të jeni fare e sigurt, — më tha një grua, — turqit nuk do të guxojnë t'ju prekin. Ata ua kanë friken miqve tuaj përtej kufirit dhe e dinë se po ndodhi gje, do t'ju marrin hakun». E shkreta ajo, i besonte këto doktrina, ndërsa fjalët e saj hidhnin një dritë të tërthortë mbi këtë jetë të errët, ku «siguria» varej nga forca e hakmarrjes.

E kisha bërë plan që të nisesha herët në mëngjesin e së nesërme, por nuk e pata atë fat. Pasaportën nuk ma kishin vullosur. Kjo u shpjegua me faktin se zotërisë së cilit i përkiste zyra për këtë punë, i kishte vdekur e bija. Ai do ta qante gjithë ditën dhe nuk mund ta ndërpriste njeri. Unë kundërshtova, por më thanë se dy a tri ditë nuk ishin ndonjë gjë e madhe për këdo dhe më lanë në një gjendje të këndshme, duke mos qenë e sigurt për asgjë se çfarë do të ndodhte.

Vonë, në mbrëmje, mora urdhër që të nisesha të nesërmen në mëngjes, në orën katër, me disa tregtarë dhe me një zaptije si shpurë. Radovani u vesh si shtetas turk dhe ne u nisëm me përpikëri në agimin e hirtë. Ishte shumë ftohtë dhe e gjithë pamja ishte turbulluar nga shiu i rëndë. E kaluam Limin nëpër një urë druri plot me të çara, të cilën ushtria turke ishte përpjekur ta ndreqte vende-vende, duke vënë shkopinj.

U ngjitëm përpjetë gjithë kohën dhe dolëm në një pllajë të gjerë. Maja e madhe e Komit të Vasojeviqit ngrihej lart nga Mali i Zi dhe një postë kufiri, një kullë druri me frengji dukej qartë në një kreshtë. «Kjo është Mokra» më tha zaptija dhe qeshi e rroku pushkën e vet, një gjest ky i panevojshëm, sepse vetë vendi fliste.

«Ky vend është i pabanuar». Janë kilometra të tëra me kullota shumë të pasura, ku nuk kullot asnjë kope, sepse kjo do t'i kushtonte jetën bariut, janë lugina pjellore, ku nuk jeton nje-

ri dhe ka pyje të mëdha me drurë të lartë bredhi. Ishim në Arnautllëk (Shqipëri), një vend, ku nuk benet asgjë dhe ku nuk njerëz që pashë, ishin disa kasolle krejt shkatërraqe dhe, natyrisht, ishin të shqiptarëve. Grupet e shqiptarëve që deri vonë e kishin mbajtur krahinën dhe e kishin bllokuar plotësisht rrugën tregtare, tani i kishin dëbuar dhe rruga ishte përsëri e lirë. Radovani fliste lirisht shqip, ashtu fliste dhe zaptija. Na dhanë ca qumësht e kafe në një kasolle shqiptarësh (binte erë të keqe, sepse muret ishin të mbuluara me lëkurë gjedhi të mbërthyera për t'u tharë), u ulëm përdhe dhe pimë po nga ajo kupë, ndërsa një tufë njerëzish të çuditshëm na u mblodhën qark dhe na bënë pyetje. Ata me mirësjellje hodhën dru në zjarr që të më thaheshin rrobat dhe për pijet, që më dhanë, pranuan vetëm pesë peni. Pastaj kaluam përmes Rugovës, një fshat i vogël shqiptar, që përbëhej nga një grusht kasollesh dhe nga një xhami druri, një vend fatkeq, që kishte qenë skena e arrestimit, para pak kohësh, të disa krerëve kryengritës dhe e shumë gjakderdhjeve. Më tej, u zhytëm në luginën e Bistricës, të veshur dendur me bredh. Shpati i pjerrët ishte një gafrrungë me rrënjë e me rrjedha balte, përmes së cilës rrëshqita më këmbë për disa kilometra, ndërsa kafshët e barrës çapiteshin me vështirësi, duke u penguar.

Ishte një pamje jashtëzakonisht e egër dhe që të bënte përshtypje. Shkëmbinjtë, në anën përballë, ngriheshin si mur pingul, mbi kokat tona ishte një qiell nate dhe hëna doli e shkëlqeu në përroin që rridhte e gurgullonte teposhtë.

Unë ecja përpara dhe më ndoqi pas zaptija. Arritëm te fundi i grykës. Zaptija më tha: «Shpejt arrijmë në Pejë, ec o zonjë ec, tashti rruga është e mirë.» Unë i hipa kalit pa dëshirë, sepse ndonëse nuk kishte ndodhur gjë, fare mirë mund të na priste ndonjë e keqe.

Më në fund, pas gjashtëmbëdhjetë orë e gjysmë udhëtimi, trokitëm te portat e mëdha të veshura me hekur të një manastiri mbi një kreshtë shkëmbore, që priste ujët e lumit dhe të rrethuar me një mur të lartë guri.